Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*

**Nr. 17/251**
**Datë: 12.03.2025**

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4. të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 mars 2025, merr këtë:

# V E N D I M

1. Aprovohet Koncept-dokumenti për Shëndetin e Bimëve.

2. Obligohet Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe institucionet e tjera kompetente për zbatimin e këtij Vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

# Republika e Kosovës
## Republika Kosovo-Republic of Kosovo
***Qeveria - Vlada – Government***

**Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural/Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja/Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development**

# KONCEPT DOKUMENTI PËR SHËNDETIN E BIMËVE

**Prishtinë 2025**

Lista e shkurtesave ........................................................................................................... 3
Hyrje.......................................................................................................................4-5
Tabela me informacione për Koncept Dokumentin.................................................................5-6
Përkufizimi i problemit ........................................................................................................6-7
Toka bujqësore ........................................................................................................................7-8
Madhësia e fermës ....................................................................................................................8
Inputet në bujqësi........................................................................................................................9
Kontrolli i sëmundjeve dhe dëmtuesve ........................................................................................9
Përshkrimi i politikës dhe kornizës ligjore ekzistuese .................................................10-16
Problemi kryesor, shkaqet dhe palët e interesuara.......................................................17-22
Kapitulli 2: Objektivat ...............................................................................................22-24
Praktikat e vendeve të rajonit lidhur me Shëndetin e Bimëve ...........................................24-27
Kapitulli 3: Opsionet...................................................................................................27-31
Praktikat e vendeve të rajonit të cilat mund të gjejnë zbatim në Kosovë...........................31-33
Kapitulli 4: Identifikimi dhe vlerësimi i ndikimeve të ardhshme ........................................33-40
Kapitulli 5: Komunikimi dhe konsultimi ............................................................................40-41
Përmbledhje nga aktivitetet për hartimin e Koncept Dokumentit .............................................41
Kapitulli 6: Krahasimi i opsioneve ..........................................................................................41
Kapitulli 6.1: Planet e zbatimit për opsionet e ndryshme................................................42-48
Kapitulli 6.2: Tabela e krahasimit me tri opsionet..........................................................48-50
Kapitulli 7: Konkluzionet dhe hapat e ardhshëm..................................................................51
Plani i zbatimit të opsionit te preferuar- Opsioni 3..........................................................52-54
Baza për hartimin e legjislacionit dhe vlerësimi i ardhshëm ............................................54-55
Shtojca 1: Formulari i vlerësimit të ndikimit ekonomik ....................................................56-60
Shtojca 2: Formulari i vlerësimit të ndikimit social..........................................................61-65
Shtojca 3: Formulari i vlerësimit të ndikimit në mjedis.....................................................66-68
Aneksi 4: Formulari i vlerësimit të ndikimit për të drejtat themelore...............................69-71

## LISTA E SHKURTESAVE

| | |
|---|---|
| **LSHB** | Ligji për Shëndetin e Bimëve |
| **MBPZHR** | Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural |
| **DPBT** | Departamenti i Politikave Bujqësore dhe Tregjeve |
| **AUV** | Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë |
| **IBK** | Instituti Bujqësor i Kosovës |
| **MB** | Mbrojtja e Bimëve |
| **PMB** | Produktet për Mbrojtjen e Bimëve |
| **MMPI** | Ministria e Mbrojtjes së Mjedisit, Planifikimit dhe Infrastrukturës |
| **MAPL** | Ministria e Administratës dhe Pushtetit Lokal |
| **MINT** | Ministria e Industrisë Ndërmarrësisë & Tregtisë |
| **ASK** | Agjencia e Statistikave të Kosovës |
| **AKP** | Agjencia Kosovare e Privatizimit |
| **PVSHB** | Plani i Veprimit për Shëndetin e Bimëve |
| **MFPT** | Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve |
| **BE** | Bashkimi Evropian |
| **NPPO** | Organizata Kombëtare për Mbrojtjen e Bimëve |
| **IPPC** | Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e Bimëve |
| **EPPO** | Organizata Evropiane për Mbrojtjen e Bimëve |
| **PI** | Prodhimtaria e Integruar |
| **MSA** | Marrëveshja e Stabilizim Asocimit |
| **PKIE** | Programi Kombëtar për Integrime Evropiane |
| **SHB** | Shëndeti i Bimëve |
| **KE** | Këshilli i Evropës |
| **LPPA** | Ligji për Procedura të Përgjithshme Administrative |
| **ISPM** | Stendat Ndërkombëtare për Materialet e Paketimit Drunor |
| **TIK** | Teknologjia e Informimit dhe Komunikimit |
| **NVM** | Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme |

## Hyrje

Koncept dokumenti për Shëndetin e Bimëve është përgatitur nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural -Departamenti i Politikave Bujqësore & Tregjeve – Divizioni i Mbrojtjes së Bimëve në përputhje me Udhëzuesin dhe Doracakun për Hartimin e Koncept Dokumenteve Nr. 95/2018 të datës 21/03/2018 dhe në përputhje me rregullat dhe procedurat e Qeverisë.

Shëndeti i bimëve është me rëndësi të veçantë për prodhimtarinë bimore, fermerët prodhues të kulturave bujqësore të cilët kanë ndikim direkt në mirëqenien sociale të tyre, si dhe ndikimi në zhvillimin e një bujqësie të qëndrueshme me ndikim ekonomik të çdo vendi, çdo herë duke pasur parasysh plotësimin e nevojave të popullatës për ushqim cilësor dhe të sigurt.

Në Republikën e Kosovës, problemet në shëndetin e bimëve janë të shumta, duke filluar në strukturën organizative institucionale në të cilën do të duheshin të definohen qartë përgjegjësitë e këtij sektori të ndjeshëm dhe të veçantë.

Në aspektin legjislativ, sektori i Mbrojtjes së Bimëve në Kosovë është zhvilluar në periudhën e vitit 2013, kur është aprovuar Ligji Nr. 04/L-120, i cili është ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-082 në përputhje me dispozitat ndëshkimore të përcaktuara me Ligjin për Kundërvajtje por jo edhe në aspektet tjera përmbajtjësore. Ligji është plotësuar me udhëzime administratave (UA) kohë pas kohe, por të cilat nuk i përmbushin nevojat dinamike aktuale të sektorit të Shëndetit të Bimëve.

Bazuar në gjendjën aktuale të sektorit të Shëndetit të Bimëve, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR) ka hartuar këtë koncept dokument (KD), në të cilin janë identifikuar dhe analizuar mangësitë e legjislacionit aktual, të cilat kanë ndikim në zhvillimin e përgjithshëm të sektorit të bujqësisë dhe i cili do t’i paraprijë Ligjit të ri për Shëndetin e Bimëve në Republikën e Kosovës.

Synimi i përgjithshëm i këtij koncept dokumenti është që të krijohet korniza e duhur ligjore e cila mundëson: prodhimin , importin , eksportin dhe tregtimin e materialit fidanor të bimëve dhe produkteve bimore të cilat janë të domosdoshme për mbrojtjen e fermerëve prodhues dhe kanë ndikim në: (a) Në zhvillimin e sektorit të prodhimtarisë bimore cilësore; (b) Rritjen e rendimenteve mesatare prodhuese të bimëve dhe produkteve bimore në nivel vendi; (c) Përfitimin e produkteve kualitative të cilat do të kenë ndikim në shëndetin publik. Objektivat specifike të përcaktuara me këtë koncept dokument janë: (1) Harmonizimi i legjislacionin vendor me legjislacion të BE-së (‘Acquis’) nga sektori i shëndetit të bimëve .

(2) Ngritja e vetëdijes për rolin dhe rëndësinë e shëndetit të bimëve dhe mbrojtja e prodhimeve nga importimi dhe tregtimi i bimëve jo cilësore, monitorimi dhe menaxhimi i sëmundjeve dhe dëmtuesve për të mbajtur bimët e shëndetshme dhe për mbrojtjen e mjedisit; (3) Tregtia e sigurtë e bimëve dhe produkteve të tyre duke zbatuar standardet vendore dhe ndërkombëtare të shëndetit të bimëve; (4) Formimi i sistemeve të paralajmërimit për monitorim të hershëm për sëmundje dhe dëmtues për të mbrojtur shëndetin e bimëve; (5) Masat për parandalimin e hyrjes dhe

përhapjes së organizmave të dëmshëm në bimë, produkte bimore dhe objekte tjera për menaxhimin dhe çrrënjosjen në kohë; (6) Grumbullimi dhe shkëmbimi i informacioneve dhe të dhënave me vendet tjera për sëmundjet dhe dëmtuesit; (7) Krijimi i Regjistrit fitosanitar për prodhuesit, përpunuesit, importuesit dhe eksportuesit e bimëve; (8) Krijimi i listave të organizmave të dëmshëm për bimët, produkte bimore dhe objektet e tjera.

Pas të gjitha analizave rreth ndikimeve në sektorin e Shëndetit te Bimëve janë përfituar tri (3) opsione të ndryshme të cilat janë shqyrtuar për arritjen e këtyre objektivave dhe në fund është konkluduar se opsioni më i përshtatshëm është "Opsioni 3, që nënkupton hartimin e Ligjit të ri për Shëndetin e Bimëve në Republikën e Kosovës.

Në tabelat në vijim janë paraqitur në formë të përmbledhur të dhënat bazë të Projekt Koncept Dokumentit për Shëndetin e Bimëve .

**Tabela me informacione të përgjithshme për Koncept Dokumentin**

| | |
|---|---|
| Titulli | Projekt Koncept Dokumenti për Shëndetin e Bimëve |
| Ministria bartëse | Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural<br>Departamenti për Politika Bujqësore dhe Tregje<br>Divizioni i Mbrojtjes së Bimëve |
| Personi kontaktues | Nehat Veliu 038/ 200 38 805 ; 045 969 303 |
| Plani Kombëtar për Zhvillim | Qëllimi zhvillimor dhe qëllimi strategjik:<br>• 1.9 Ndërtimi i lidhjeve të qëndrueshme në mes të fermerëve, prodhuesve, përpunuesve dhe shitësve me pakicë<br>• Masa Strategjike: Përmbushja e kërkesave për ushqim të sigurtë dhe të shëndetshëm<br>• Aktiviteti– Hartimi i Projekt Koncept Dokumentit për Shëndetin e Bimëve |
| Prioriteti strategjik | **Objektivi strategjik**:<br>Avancimi i politikave për siguri ushqimore dhe përafrimi i tyre me standardet e BE-së, të cilat synojnë të sigurojnë nivel të lartë të ushqimit të sigurtë për njeriun, kafshët dhe shëndetin e bimëve, si dhe masat mbrojtëse kundër hyrjes së organizmave të dëmshëm për bimët ose produktet bimore .<br>**Objektivat specifike**:<br>1.Harmonizimi i legjislacionin vendor me legjislacion të BE-së ('Acquis') nga sektori i shëndetit të bimëve .<br>2.Ngritja e vetëdijes për rolin dhe rëndësinë e shëndetit të bimëve dhe mbrojtja e prodhimeve nga importimi dhe tregtimi i bimëve jo cilësore si dhe menaxhimi i sëmundjeve dhe dëmtuesve për të mbajtur bimët e shëndetshme dhe për mbrojtjen e mjedisit.<br>3. Tregtia e sigurtë e bimëve dhe produkteve të tyre duke zbatuar standardet vendore dhe ndërkombëtare të shëndetit të bimëve.<br>4.Formimi i sistemeve të paralajmërimit për monitorim të hershëm për sëmundje dhe dëmtues për të mbrojtur shëndetin e bimëve.<br>5. Masat për parandalimin e hyrjes dhe përhapjes së organizmave të dëmshëm në bimë, produkte bimore dhe objekte tjera për menaxhimin dhe çrrënjosjen në kohë. |

| | |
|---|---|
| | 6. Grumbullimi dhe shkëmbimi i informacioneve dhe të dhënave me vendet tjera për sëmundjet dhe dëmtuesit.<br>7. Krijimi i Regjistrit fitosanitar për prodhuesit, përpunuesit, importuesit dhe eksportuesit e bimëve.<br>8.Krijimi i listave të organizmave të dëmshëm për bimët, produkte bimore dhe objektet e tjera.<br>9.Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve, përmes zvogëlimit të barrës administrative për palët. |
| Qëllimi | Koncept Dokument ka për qëllim të adresoj çështjet të cilat nuk kanë qenë të përfshira me rregullativën aktuale ligjore të Mbrojtjes së Bimëve. |
| Grupi punues | Me Vendimin Nr.50 Ref. ZSP 90/24 i datës 28.02.2023, Sekretari i Përgjithshëm i MBPZhR-së ka emëruar Grupin Punues për hartimin e Koncept Dokumentit për Produkte për Mbrojtjen e Bimëve:<br>Nehat Veliu-Kryesues; Selvije Blakaj; Shaban Hamzaj; Isah Rudaku; Arian Bugari; Arnesa Ferizi; Veton Çoçaj; Leonora Arifi; Merita Ramaxhiku; Burim Ahmeti; Ekrem Ahmeti; Valbona Fetahu dhe Bekri Xhemajli. |
| Informata shtesë | Republika e Kosovës në proceset integruese në BE është zotuar dhe ka marrë të gjitha obligimet në përafrimin dhe harmonizimin e legjislacionit dhe politikat zhvillimore, që kanë të bëjnë me shëndetin e njeriut, kafshëve dhe bimëve në zinxhirin agro-ushqimor që janë fundamentale për shëndetin e konsumatorit, zhvillimin ekonomik të vendit dhe mbrojtjen e mjedisit.<br>Raporti për Kosovën i Komisionit Evropian i vitit 2023 citon:<br>Të sigurohen në kohë mjete dhe burime financiare dhe njerëzore të mjaftueshme për të përmbushur ne mënyre efikase detyrat dhe përgjegjësit e mandatit për të cilin është thirrur (ruajta e sigurisë ushqimore);<br>Të marrë masa për funksionalizimin dhe menaxhimin e përpunuesve, prodhuesve, tregtuesve, deponuesve, grumbulluesve të produkteve me origjinë bimore. |

## Kapitulli 1: Përkufizimi i problemit

Korniza aktuale ligjore e Republikës së Kosovës për Mbrojtjen e Bimëve nuk ka pësuar ndryshime që nga viti 2013 me qëllim të përafrimit të legjislacionit vendor për mbrojtjen e bimëve me Rregulloren e BE-së 2016/2031 për shëndetin e bimëve. Për këtë arsye ky legjislacion duhet të rishikohet dhe të harmonizohet me Rregulloren e BE-së 2016/2031.

Zhvillimi i sektorit të bujqësisë është i varur shumë nga gjendja shëndetësore e bimëve, monitorimi dhe menaxhimi i sëmundjeve, dëmtuesve si dhe nga kontrolli i përdorimit të Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve PMB-ve. Përdorimi i PMB-ve ka një rol të rëndësishëm ne shëndetin bimor për arritjen e synimeve strategjike të përcaktuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës duke përfshirë rritjen e prodhimit vendor të produkteve dhe sigurimin e ushqimit.

**Sfidat kryesore për Shëndetin Bimor:**

- Krijimi dhe  mbajtja e regjistrit fitosanitar për  prodhim, përpunim, paketim, importim, eksportim, deponim, shpërndarjen e bimëve, produkteve bimore dhe objekteve tjera;
- Mungesa e pamjaftueshme e instituteve dhe laboratorëve profesional që merren me shëndetin e bimëve, me qëllim të kryerjes së analizave dhe vlerësimit të gjendjes;
- Shkëmbimi i informacioneve në lidhje me shëndetin e bimëve në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar (NPPO, IPPC, EPPO etj.);
- Autorizimi i një ndërmarrjeje - subjekti juridik për lëshimin e pasaportave të bimëve;
- Zbatimi i mbikëqyrjes së intensifikuar të dëmtuesve prioritet dhe të tjerë karantinë (përfshirë marrjen e mostrave) dhe monitorimin e vektorëve;
- Zbatimi i një sistemi pasaportash bimore plotësisht në përputhje me kërkesat e BE-së;
- Ofrimi i mendimeve shkencore nga ekspertë për ndihmë diagnostike dhe teknike për inspektorin fitosanitar;
- Krijimi i një sistemi të menaxhimit të krizave për shpërthimet e sëmundjeve dhe dëmtuesve /zonat e përcaktuara në nivel kombëtar.

**Toka bujqësore**

Bazuar nga Anketa e Ekonomive Bujqësore, gjithsej sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore ka pasur një trend të përafërt të shfrytëzimit në periudhën kohore 2017-2022. Gjithsej sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore në vitin 2022 ishte 420,482 ha, që ishte sipërfaqe e përafërt me atë të vitit 2021. Sipërfaqja mesatare e tokës së shfrytëzuar bujqësore për Ekonomi Bujqësore ishte 3.2 ha. Ekonomitë familjare kanë rreth 2-5 ha të sipërfaqes së shfrytëzuar të tokës bujqësore e që përbëjnë rreth 23.3% të sipërfaqes së përgjithshme. Numri i Ekonomive Bujqësore në Kosovë është 130 ,775. Sipas të dhënave të pranuara nga Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP), toka bujqësore e  privatizuar deri me tani është përafërsisht 30,217 ha. Ndërsa, ka mbetur nën menaxhim të AKP-së përafërsisht rreth 40,000 ha tokë bujqësore.

**Shfrytëzimi i tokës bujqësore sipas kategorive**

| | 2017 | 2018 | 2019 | 2020 | 2021 | 2022 |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Tokë e punueshme – Ara | 186,954 | 188,359 | 188,365 | 188,372 | 188,375 | 188,404 |
| Perime, Kopshte dhe Fidanishte | 9,858 | 9,398 | 10,070 | 10,252 | 10,283 | 10,079 |
| Plantacione të pemëve | 6,247 | 7,687 | 9,244 | 10,029 | 10,144 | 10,377 |
| Plantacione të vreshtave | 3,199 | 3,272 | 3,367 | 3,437 | 3,471 | 3,472 |
| Livadhe dhe kullosa përfshirë tokën e përbashkët | 218,314 | 218,152 | 217,932 | 217,102 | 217,107 | 216,998 |

- Burimi: ASK – Anketa e ekonomive bujqësore (’17,’18,’19,’20, ’21 ‘22)

Përveç livadheve dhe kullosave me 216,998 ha, që përbën 51.6% të gjithsej sipërfaqes së shfrytëzuar të tokës bujqësore, pastaj janë tokat e punueshme, me pjesëmarrje prej 44.8%, që paraqesin sipërfaqen prej 188,404 ha, ku përfshihet dhe sipërfaqja e perimeve në fushë të hapur (si kulturë e parë), (8,584 ha) dhe perimet në serra po ashtu si kulturë e parë (583.3 ha), pra

gjithsej 9,167 ha me perime (ASK, 2023). Drithërat kokërr janë mbjellë në 124, 617,49 ha ose (66,1%) të sipërfaqes së tokës së punueshme, grupi i dytë për nga madhësia e sipërfaqes së kulturave në tokën e punueshme - ara janë kulturat foragjere me 37 614,61 ha ose (20,0 %) të sipërfaqes së tokës së punueshme (ASK, 2023).

## Madhësia e fermës

Sipërfaqja e tokës së punueshme e shfrytëzuar i referohet sipërfaqes kryesore gjatë një viti të prodhimit bujqësor. Në vitin 2020, gjithsej sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore ishte 420,210 ha, nga kjo sipërfaqe gjithsej toka e punueshme-ara ishin 186,389 ha apo 44% ku janë të përfshira 103,723 ekonomi bujqësore.

**Madhësia e ekonomive sipas sipërfaqes së tokës së punueshme 2020**

| Madhësia e fermës | Sipërfaqja (ha) | Pjesëmarrja (%) | Nr. i Ekonomive Bujqësore | Pjesëmarrja (%) |
|---|---|---|---|---|
| 0 dhe më pak se 0.5 | 6,453 | 3.5 | 31,290 | 30.2 |
| 0.5 deri më pak se 1 | 11,999 | 6.4 | 17,560 | 16.9 |
| 1 deri më pak se 2 | 29,005 | 15.6 | 22,560 | 21.8 |
| 2 deri më pak se 5 | 38,665 | 20.7 | 23,383 | 22.5 |
| 5 deri më pak se 10 | 64,819 | 34.8 | 7,063 | 6.8 |
| 10 deri më pak se 20 | 16,800 | 9.0 | 1,429 | 1.4 |
| 20 deri më pak se 30 | 5,255 | 2.8 | 240 | 0.2 |
| 30 e më shumë | 13,393 | 7.2 | 198 | 0.2 |
| Gjithsej* | **186,389** | **100%** | **103,723** | **100%** |

Burimi: ASK – Anketa e ekonomive bujqësore 2020
*Nuk janë përfshirë; Ekonomive Bujqësore të Komunave Veriore

Në Kosovë madhësia e fermës prej 5 deri më pak se 10 ha përfaqëson 35% të gjithsej sipërfaqes së tokave të punueshme arave, pasuar nga madhësia e fermave prej 2 deri më pak se 5 ha (21%), madhësia 1 deri më pak se 2 ha (16%) dhe madhësitë e tjera me më pak pjesëmarrje ku madhësia me sipërfaqen më të vogël është ajo prej 0 deri më pak se 0.5 ha.

## Inputet në Bujqësi

Nga të dhënat e Llogarive Ekonomike për Bujqësi të vitit 2022 vlen të ceket se struktura e konsumit të ndërmjetëm bujqësor këtë vit nuk dallon shumë me atë të vitit 2021. Shumica e

kategorive në vitin 2021, krahasuar me vitin 2022 kishin përqindje të pjesëmarrjes së njëjtë, dallim shumë të vogël përbëjnë kategoritë e ushqimit të kafshëve, farave dhe materialit mbëltues, shërbimeve bujqësore, plehrat dhe përmirësuesit e tokës si dhe energjia dhe lubrifikantët, të cilat kanë shënuar rritje shumë të lehtë, kategoritë tjera përqindjen e pjesëmarrjes e kanë pasur të njëjtë sikurse në vitin 2021.

Sa i përket strukturës së konsumit të ndërmjetëm bujqësor për vitin 2022, të dhënat na tregojnë se pjesëmarrje më e madhe në këtë strukturë paraqet kategoria e ushqimit të kafshëve me 53%, pasuar nga kategoria e plehrave dhe përmirësuesit e tokës me 14%, mallrat dhe shërbimet tjera me 9%, energjia dhe lubrifikantët 7%, shërbimet bujqësore 5%, shpenzimet veterinere dhe mirëmbajtja e materialeve me nga 3%, produktet për mbrojtjen e bimëve dhe pesticidet 2%, si dhe kategoria e mirëmbajtjes së ndërtesave me pjesëmarrje prej 1%.

Lidhur me inputet në bujqësi për vitin 2022, sikurse kategoritë e strukturës së konsumit të ndërmjetëm edhe kategoritë e inputeve në bujqësi krahasuar me vitin 2021 nuk paraqiten me ndonjë dallim të madh.

Referuar të dhënave në figurën e mëposhtme, inputet në bujqësi sipas kategorive për vitin 2022 kanë këtë pjesëmarrje: konsumi i ndërmjetëm 72%, konsumi i kapitalit fiks 25%, ndërsa kategoritë tjera si kompensimi i punëtorëve, qiraja dhe shpenzimet tjera për shfrytëzimin e tokës dhe ndërtesave dhe interesi i papaguar kanë pjesëmarrje me nga 1%.

(Raporti i Gjelbër i Kosovës, MBPZHR 2023).

**Kontrolli i sëmundjeve dhe dëmtuesve**

Për momentin asnjë institucion nuk e kryen hulumtimin e sëmundjeve dhe dëmtuesve në kultura bimore. Hulumtimi dhe identifikimi i sëmundjeve dhe dëmtuesve duhet të realizohet nga institutet e specializuara/akredituara si: Instituti Bujqësor i Kosovës dhe Institutet tjera të specializuar/akredituara, si dhe Universitetet që kanë programe specifike dhe laboratorë për mbrojtjen e bimëve. Njëkohësisht për këtë qëllim inspektorët fitosanitar duhet të kryejnë trajnime shtesë lidhur me marrjen e mostrave për analiza të sëmundjeve dhe dëmtuesve në kulturat bimore.

**Ofrimi i Shërbimeve Këshillimore per Shëndetin e Bimëve**

Në kuadër të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR) ekziston dhe Departamenti i Shërbimeve Këshillimore dhe Teknike i cili ofron këshilla bujqësore dhe ka shtrirje edhe në nivel lokal përmes së cilit shpërndahen të gjitha informacionet lidhur me sëmundjet dhe dëmtuesit që paraqiten/shfaqen në kulturat e ndryshme bujqësore. Në Kosovë gjithashtu ekzistojnë dhe kompani këshilluese private të cilat merren me ofrimin e shërbimeve këshillimore.

**Zhvillimi  i sektorit per Shëndetin e Bimëve**

Institucionet kryesore që janë të përfshira lidhur me shëndetin e bimëve (MBPZHR-DPBT/ AUV/IBK, MMPHI, Doganës së Kosovës, Fakultetet e Bujqësisë (publike dhe private, kompanive prodhuese të materialit fidanor dhe farës, etj.) duhet forcuar bashkëpunimin në mënyrë që të prodhojmë produkte bujqësore sa më të sigurta për nevojat vendore dhe eksport.

**Përshkrimi i politikës dhe kornizës ligjore ekzistuese**

Korniza aktuale ligjore për mbrojtjen e bimëve është rregulluar me Ligjin Nr. 04/L-120 për Mbrojtjen e Bimëve (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 1/17 janar 2013). Me akte nën ligjore që derivojnë nga ky Ligj janë rregulluar fitocertifikatat për eksport, ri-eksport dhe fitocertifikatat për qarkullim të brendshëm të bimëve, produkteve bimore dhe objekteve tjera, mbajtja e regjistrit fitosanitar për  prodhim, paketim, përpunim, importim, eksportim, deponim, shpërndarjen e bimëve, produkteve bimore dhe objekteve tjera, procedurat e kontrollit inspektues, si dhe lajmërimi i sëmundjeve dhe dëmtuesve. Që nga hyrja në fuqi e Ligjit për Mbrojtjen e Bimëve nuk ka pasur plotësime dhe ndryshime. Marrë parasysh shëndetin e bimëve, zhvillimin ekonomik të vendit dhe mbrojtjen e mjedisit Parlamenti Evropian dhe Këshilli i Evropës në Tetor 2016 miratuan Rregulloren (BE) 2016/2031 mbi Masat Mbrojtëse Kundër Dëmtuesve të Bimëve, duke ndryshuar Rregulloret (BE) Nr 228/2013, (EU) Nr 652/2014 dhe (BE) Nr. 1143/2014 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të Evropës, si dhe duke shfuqizuar Direktivat e Këshillit 69/464/EEC, 74/647/EEC, 93/85/EEC, 98/57/EC, 2000/29/EC, 2006/91/EC dhe 2007/33/EC.

Ligji për Shëndetin e Bimëve do të harmonizohet me Rregulloren (BE) 2016/2031. Qëllimi i kësaj rregulloreje është të siguroj një nivel të lartë mbrojtjeje të shëndetit të bimëve të njerëzve, të kafshëve, mjedisit si dhe të përmirësoj funksionimin e tregut të brendshëm nëpërmjet harmonizimit të rregullave për shëndetin e bimëve.

**Përshkrimi i politikës dhe kornizës ligjore ekzistuese**

Tabela 1: Dokumentet legjislative dhe politike dhe përgjegjësitë e institucioneve

| **Dokument i politikave, ligj ose akti nën-ligjor** | **Lidhja (linku) me politikën apo dokumentin planifikues përmes internetit ose me aktet ligjore në Gazetën Zyrtare** | **Institucioni (et) shtetëror (e) përgjegjës (e) për zbatim** | **Roli dhe detyrat e Institucionit (eve)** |
|---|---|---|---|
| Ligji Nr. 04/L-120 Për Mbrojtjen e Bimëve | https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2863 | Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural | Hartimi i politikave dhe legjislacionit për Mbrojtjen e |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | (MBPZHR)<br><br>Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV)<br><br>Instituti Bujqësor i Kosovës në Pejë (IBK) | Bimëve dhe produkteve bimore nga organizmat e dëmshëm.<br><br>Zbatimi i legjislacionit primar dhe sekondar<br><br>Analizimi i mostrave të marruara nga AUV |
| Ligji Nr.08/L-082 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-120 Për Mbrojtjen e Bimëve | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=62063 | Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR)<br><br>Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV)<br><br>Institucionet kompetente gjyqësore-gjykatat | Harmonizimi i dispozitave ndëshkimore me Ligjin për Kundërvajtje shqiptimi i sanksioneve kundërvajtëse me gjobë<br><br>Zbatimi i Ligjit për sanksionet kundërvajtëse<br><br>Shqiptimi i gjobave kundërvajtëse |

| | | | |
|---|---|---|---|
| Udhëzim Administrativ (MBPZHR) - NR.11/2022 Për Përmbajtjen dhe Mënyrën e Mbajtjes së Regjistrave Fitosanitar për Prodhimin, Paketimin, Përpunimin, Importin, Eksportin, Deponimin, Shpërndarjen e Bimëve, Produkteve Bimore dhe Objekteve Tjera | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=65951 | MBPZHR<br>AUV<br>IBK | Përcakton kushtet, përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes se regjistrimit fitosanitar të cilët prodhojnë, importojnë, eksportojnë dhe tregtojnë bimë, produkte bimore dhe objekte të tjera si dhe masat mbrojtëse kundër paraqitjes së organizmave të dëmshëm. |
| Udhëzim Administrativ (MBPZHR) - NR. 01/2022 për Formën dhe Përmbajtjen e Çertifikatave Fitosanitare | https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=57209 | MBPZHR<br>AUV<br>IBK | Përcakton formën dhe përmbajtjen e çertifikatave fitosanitare të cilat lëshohen për eksport, import dhe qarkullim të brendshëm të bimëve, produkteve bimore dhe objekteve të tjera |
| Udhëzim Administrativ (MBPZHR) NR. 13/2014 Për Procedurat e Kontrollit Inspektues | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10077 | MBPZHR<br>AUV | Përcakton procedurat, format dhe mënyrat e kontrollit inspektues të bimëve, produkteve bimore dhe objekteve tjera nç pikat kufitare të Republikës së Kosovës. |

| | | | |
|---|---|---|---|
| Udhëzim Administrativ (MBPZHR) NR. 12/2014 Për Parandalimin, Luftimin dhe Asgjësimin e Sëmundjes Djegia Bakteriale - *Erëinia Amylovora* | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10059 | MBPZHR<br>AUV<br>IBK | Përcakton masat për zbulimin, parandalimin, luftimin dhe asgjësimin e sëmundjeve “*Djegia bakteriale Erwina amylovora*” në territorin e Republikës së Kosovës. |
| Ligji Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12559 | Zyra e Kryeministrit dhe Ministritë e linjës | Roli i këtij ligji është të siguroj realizimin efektiv të autoritetit publik në shërbim të interesit publik, duke garantuar në të njëjtën kohë mbrojtjen e të drejtave dhe të interesave juridike të personave, vendos për të drejtat, detyrimet dhe interesat juridike të personave, si dhe çdo rast tjetër kur ligji parashikon shprehimisht nxjerrjen e një akti administrativ, ose lidh një kontratë administrative ose zbaton kompetencat e veta përmes akteve reale që kanë të bëjnë me të drejtat, detyrimet dhe |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | | interesat juridike të personave. |
| Ligji Nr. 05/L-087 për Kundërvajtje | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12839 | Ministria e Drejtësisë MBPZHR | Roli i këtij ligji është rregulloj kushtet për përcaktimin e kundërvajtjeve dhe sanksioneve për kundërvajtje, palët dhe përgjegjësia për kundërvajtje, procedura e kundërvajtjes, procedura e veçantë për të mitur dhe procedura e ekzekutimit të sanksioneve për kundërvajtje. |
| Ligji nr. 04/L-202 për Sistemin e Lejeve dhe Licencave. | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8967 | Zyra e Kryeministrit dhe Ministritë e linjës | Roli i këtij ligji është të vendos parimet dhe rregullat për përmirësimin e mjedisit për të bërë biznes nëpërmjet reduktimit të barrierave administrative, në kryerjen e veprimtarive ekonomike, tregtare apo profesionale, që është e domosdoshme për të mbrojtur shëndetin publik, sigurinë publike, mjedisin dhe përdorimin e resurseve natyrore në Republikën e Kosovës. |
| Ligji Nr.08/L-172 Për Sigurinë e | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=71 | Zyra e Kryeministrit dhe | Roli i këtij ligji është që të siguroj |

| | | | |
|---|---|---|---|
| Përgjithshme të Produkteve | 816 | Ministritë e linjës | që produktet e vendosura në treg të jenë të sigurta dhe e përcakton kërkesën e përgjithshme të sigurisë për produktet, detyrimet e prodhuesve dhe shpërndarësve, informimin e publikut, nxitjen/marrjen e masave vullnetare dhe mbikëqyrjen inspektuese për përmbushjen e kërkesave të përcaktuara. |

| | | | |
|---|---|---|---|
| Ligji Nr.03/L-025 Për Mbrojtjen e Mjedisit | https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2631 | Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Ministritë tjera të linjës | Roli i këtij ligji është te harmonizohet zhvillimi ekonomik dhe mirëqenia sociale me parimet themelore për mbrojtjen e mjedisit sipas konceptit të zhvillimit të qëndrueshëm dhe të promovoj krijimin e mjedisit të shëndetshëm për popullin e Kosovës me sjelljen graduale të standardeve për mjedis të Bashkimit Evropian. |

| | | | |
|---|---|---|---|
| Ligji nr. 06/l-034 për Mbrojtjen e Konsumatorit | https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=16551 | MINT dhe Ministritë e linjës | Roli i këtij ligji është rregullimi i kushteve të tregut në marrëdhëniet biznes me konsumator duke përfshirë etiketimin e produkteve, treguesit e çmimeve, shërbimet publike dhe praktikat e padrejta tregtare; të drejtat e konsumatorëve në lidhje me kontratat, duke përfshirë kushtet e padrejta të kontratës, shitjeve në distancë dhe jashtë mjedisit biznesor, kontratave jokonformë, kontratave të kredive për konsumatorë dhe kontratave të produkteve turistike; mbrojtjen administrative dhe gjyqësore të interesave të konsumatorëve; kuadrit institucional për mbrojtjen e konsumatorit në Republikën e Kosovës. |

## Marrja e mostrave për analizimin e sëmundjeve dhe dëmtuesve

Mostrat e marra nga inspektorët fitosanitar për sëmundje dhe dëmtues dërgohen për analiza në Institutin Bujqësor të Kosovës – Pejë (IBK) dhe laboratorët e tjerë të akredituar .

**Problemi kryesor, shkaqet dhe palët e interesuara**
**Pema e problemit që paraqet problemin kryesor, shkaqet e tij dhe efektet**

| | |
|---|---|
| **Efektet** | **<u>Rregullat nuk zbatohen siç duhet - Rregullat janë të pakompletuara</u>**<br><br>1.Vështirëson procesin e identifikimit ,hulumtimit monitorimit dhe menaxhimit të sëmundjeve , dëmtuesve dhe objekteve tjera .<br>2. Mos zbatimi i mjaftueshëm i standardeve të kërkuara nga BE në identifikim dhe hulumtim të sëmundjeve dhe dëmtuesve.<br>3.Pamundëson qasjen e personave juridik dhe fizikë në regjistrat elektronik fitosanitar për prodhim, paketim, përpunim, importim, eksportim, deponim, shpërndarjen e bimëve, produkteve bimore dhe objekteve tjera.<br>4. Mos monitorimi i integruar i sëmundjeve dhe dëmtuesve ndikon në uljen e prodhimit bujqësor.<br>5.Mungesa e planit nacional për mbrojtjen e bimëve ndikon në mos identifikimin e sëmundjeve dhe dëmtuesve në kohë.<br>6.Mos mbikëqyrja e rregullt e shpërthimit të dëmtuesve ndikon në uljen e rendimentit dhe cilësisë se prodhimeve bujqësore.<br>7. Mundësia e keqpërdorimit në paraqitjen e të dhënave të rrejshme të cilësisë dhe sigurisë se prodhimeve dhe produkteve bujqësore.<br>8. Palët hasin barrë të lartë administrative gjatë qasjes në shërbimet relevante.<br>9. Mos-mbajtja e regjistrit fitosanitar për prodhim, paketim, përpunim, importim, eksportim, deponim, shpërndarjen e bimëve, produkteve bimore dhe objekteve tjera. |
| **Problemi kryesor** | **Sistemi i Mbrojtjes (Shëndetit) të Bimëve nuk është mjaftueshëm funksional dhe i harmonizuar me kërkesat e BE-së.** |
| **Shkaqet** | **<u>Rregullat nuk zbatohen siç duhet:</u>**<br>1.Mungesa e funksionalizimit të mjaftueshëm të Sistemit të Mbrojtjes (Shëndetit) të Bimëve.<br>2. Korniza aktuale ligjore e pa harmonizuar me Rregulloren (BE) 2016/2031.<br>3. Mungesa e monitorimit të integruar të sëmundjeve dhe dëmtuesve në bimë.<br>4. Mungesa e planit nacional për identifikimin e sëmundjeve dhe dëmtuesve karantinor.<br>5. Mungesa e mbikëqyrjes nga shpërthimet e dëmtuesve të veçantë.<br>6. Mungesa e harmonizimit të dispozitave ndëshkimore.<br>7. Përpjekje të pamjaftueshme për thjeshtim dhe digjitalizim gjatë ofrimit të shërbimeve.<br><br>**<u>Rregullat janë të pakompletuara:</u>**<br>Ligjit Nr. 04/L-120 për Mbrojtjen e Bimëve dhe aktet nënligjore nuk janë të përafruara me Rregulloren (BE) 2016/2031 mbi Masat Mbrojtëse Kundër Sëmundjeve dhe Dëmtuesve të Bimëve, prandaj korniza aktuale ligjore e Kosovës për Mbrojtjen e Bimëve është e pa kompletuar siç përcaktohet me |

| | |
|---|---|
| | rregulloret dhe direktivat e BE-së, ndërsa janë plotësuar dhe ndryshuar me udhëzime administrative, por të cilat nuk përmbushin nevojat dinamike aktuale të sektorit të Mbrojtjes së Bimëve.<br><br>**<u>Mangësitë në kornizën aktuale Ligjore të Mbrojtjes së Bimëve</u>**<br>1. Krijimi dhe mbajtja e regjistrit fitosanitar për prodhim, paketim, përpunim, importim, eksportim, deponim, shpërndarjen e bimëve, produkteve bimore dhe objekteve tjera;<br>2. Shkëmbimi i informacionit në lidhje me shëndetin e bimëve në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar;<br>3. Kryerja e analiza dhe vlerësimi i gjendjes shëndetësore të bimëve;<br>4. Autorizimi i një ndërmarrje për lëshimin e pasaportave të bimëve;<br>5. Zbatimi i mbikëqyrjes së intensifikuar të dëmtuesve prioritar dhe të tjerë karantinë (përfshirë marrjen e mostrave) dhe monitorimin e vektorëve;<br>6. Zbatimi i një sistemi pasaportash bimore plotësisht në përputhje me kërkesat e BE-së;<br>7. Ofrimi i këshillave dhe hulumtimeve shkencore nga ekspertët përkatës;<br>8. Trajnime profesionale dhe teknike për inspektorët fitosanitar lidhur me identifikimin dhe diagnostikimin e sëmundjeve dhe dëmtuesve;<br>9. Krijimi i komisionit për menaxhimin e krizave për shpërthimet/zonat e përcaktuara nga sëmundjet dhe dëmtuesit në nivel kombëtar.<br>10 Standardi Ndërkombëtar për Masat Fitosanitare Nr. 15 *Rregullorja e Materialit të Paketimit të Drurit në Tregtinë Ndërkombëtare* (ISPM15)<br>Kërkon që materiali i paketimit të drurit të shënohet me një shenjë specifike të aplikuar nga operatorë profesionistë të autorizuar dhe të mbikëqyrur siç duhet. Kjo rregullore duhet të përcaktoj kërkesat në lidhje me trajtimin, shënjimin dhe riparimin e materialit të paketimit të drurit në përputhje me atë standard. Kjo rregullore duhet gjithashtu të përcaktoj rregulla për autorizimin dhe mbikëqyrjen e operatorëve profesionistë në territorin e Bashkimit që aplikojnë atë markë.<br>11 Mos harmonizimi me LPPA, Ligjin për leje dhe licenca dhe Ligjin për kundërvajtje, sidomos sa i takon zbatimit të parimit 'vetëm një herë', ofrimit me kohë (afatet), mos-pagesa si dhe parimet e mbulueshmërisë së kostos. |

## SHKAQET E PROBLEMIT

1. **Mungesa e funksionalizimit të mjaftueshëm të Sistemit të Mbrojtjes (Shëndetit) të Bimëve .**
2. **Korniza aktuale ligjore e pa harmonizuar me Rregulloren (BE) 2016/2031.**

Kornizat aktuale ligjore nuk janë të përafruara sa duhet me Rregulloren (BE) 2016/2031 mbi Masat Mbrojtëse Kundër Sëmundjeve dhe Dëmtuesve të Bimëve, prandaj korniza aktuale ligjore e Kosovës për Mbrojtjen e Bimëve është e pa kompletuar siç përcaktohet me rregulloret dhe direktivat e BE-së, ndërsa janë plotësuar dhe ndryshuar me udhëzime administrative të cilat nuk përmbushin nevojat dinamike aktuale të sektorit të Mbrojtjes së Bimëve.

3. **Mos mbajtja e regjistrit fitosanitar për prodhim, paketim, përpunim, importim, eksportim, deponim, shpërndarjen e bimëve, produkteve bimore dhe objekteve tjera.**

Mos-mbajtja e regjistrit vështirëson procesin e identifikimit të operatorëve profesional të cilët prodhojnë, importojnë, eksportojnë dhe tregtojnë bimë, produkte bimore dhe objekte tjera si dhe masat mbrojtëse tjera kundër paraqitjes së organizmave të dëmshëm.

4. **Mungesë e monitorimit të integruar të sëmundjeve dhe dëmtuesve në bimë.**

Rregullimi i bazës ligjore për monitorimin e integruar të dëmtuesve krijon mundësinë në ndërmarrjen e veprimeve për të zvogëluar varësinë e fermerëve në përdorim e produkteve për mbrojtjen e bimëve. Prodhimtaria e Integruar (PI) është një sistem bujqësor që ka për qëllim prodhimin e ushqimit cilësor dhe produkteve tjera duke përdorur burimet natyrore dhe mekanizmat tjerë të cilët zëvendësojnë inputet që shkaktojnë ndotje me qëllim të krijimit të një bujqësie të qëndrueshme. Metodat biologjike, bujqësore dhe kimike janë të balancuar duke marrë në konsideratë mbrojtjen e ambientit, përfitimit dhe çështjeve apo kërkesave shoqërore. Andaj, mungesa e bazës ligjore për monitorim të integruar ndikon në zvogëlimin e prodhimeve dhe cilësisë së prodhimtarisë së integruar bujqësore.

5. **Mungesa e planit nacional për identifikimin e sëmundjeve dhe dëmtuesve karantinorë**

Plani nacional për identifikimin e sëmundjeve dhe dëmtuesve karantinorë synon identifikimin, monitorimin dhe menaxhimin e sëmundjeve dhe dëmtuesve karantinorë. Andaj, mungesa e këtij plani ndikon ne zvogëlimin e mundësisë së identifikimit të sëmundjeve dhe dëmtuesve karantinorë dhe të tjera.

6. **Mungesa e mbikëqyrjes nga shpërthimet e dëmtuesve të veçantë**

Mungesa e mbikëqyrjes shkakton invazion të përhapjes së sëmundjeve dhe dëmtuesve në bimë dhe si pasojë e kësaj shkakton uljen e prodhimit dhe mund të rrezikoj marrjen e masave përkatëse për eliminimin/zhdukjen/asgjësimin e kulturave bimore. Nuk është bërë mbikqyerja nga shpërthimet e dëmtueseve të veçantë përshkak mungesësë resurseve njerëzore, dhe mungesa e mjeteve financiare

7. **Mos-harmonizimi i dispozitave ndëshkimore**
8. **Përpjekje të pamjaftueshme për thjeshtim dhe digjitalizim gjatë ofrimit të shërbimeve**

**<u>Efektet:</u>**

1. **Vështirëson procesin e identifikimit, hulumtimit, monitorimit dhe menaxhimit të sëmundjeve dhe dëmtuesve dhe objekteve tjera**

2. **Mos zbatimi i mjaftueshëm i standardeve të kërkuara nga BE në identifikim dhe hulumtim të sëmundjeve dhe dëmtuesve**

Mungesa e përafrimin të legjislacionit nacional me atë të BE-së zvogëlon zbatimin e standardeve në nivel më të lartë për mbrojtjen e shëndetit të bimëve, produkteve bimore dhe objekteve tjera që ndikojnë drejtpërdrejtë në ruajtjen e shëndetit të njerëzve, kafshëve dhe ambientit jetësor në përgjithësi.

3. **Pamundësimi i qasjes së subjekteve juridike dhe personave tjerë në regjistrat elektronik fitosanitar për prodhim, paketim, përpunim, importim, eksportim, deponim, shpërndarjen e bimëve, produkteve bimore dhe objekteve tjera**

Mungesa e regjistrave fitosanitar vështirëson mundësinë e identifikimit të prodhuesve, paketuesve, përpunuesve, eksportuesve, importuesve, deponuesve, shpërndarësve të bimëve, produkteve bimore dhe objekteve tjera për monitorim dhe menaxhim më efikas të sëmundjeve dhe dëmtuesve.

4. **Mos monitorimi i integruar i sëmundjeve dhe dëmtuesve ndikon në uljen e prodhimit bujqësor**

Monitorimi jo i rregullt i integruar ndikon në mundësinë e paraqitjes së sëmundjeve dhe dëmtuesve dhe zvogëlimin e të korrave dhe uljen e rendimentit dhe cilësisë, ndoshta dhe shkatërrimin e prodhimeve bujqësore. Prandaj, përdorimi dhe promovimi i praktikave parandaluese (monitorimit) minimizon rrezikun e paraqitjes së dëmtuesve që kërcënojnë kulturat bujqësore, biodiversitetin dhe qasjen në tregjet e eksportit.

Aplikimi i praktikave të mira bujqësore, prodhimtaria e integruar dhe ofrimi i këshillave për fermer do të ndikojnë në përmirësimin e shëndetit të bimëve dhe kontrollin e dëmtuesve.

5. **Mungesa e planit nacional për mbrojtjen (shëndetin) e bimëve ndikon në mos identifikimin e sëmundjeve dhe dëmtuesve në kohë**

Mungesa e një plani nacional për mbrojtjen (shëndetin) e bimëve mund të ndikoj në mos identifikimin e sëmundjeve dhe dëmtuesve të bimëve me kohë. Prandaj, hartimi i një plani nacional afatgjatë mbi mbrojtjen e shëndetit të bimëve do të ndikonte në menaxhimin e dëmtuesve dhe sëmundjeve të bimëve. Gjithashtu rol kyç ka zbatimi i tij me kohë.

6. **Mos mbikëqyrja e rregullt e shpërthimit të dëmtuesve ndikon në uljen e rendimentit dhe cilësisë së prodhimeve bujqësore**

Mbikëqyrja e rregullt ndikon në mbrojtjen e shëndetit bimor dhe mbajtjen e situatës nën kontroll e cila mundëson marrjen e masave preventive dhe parandalimin e shpërthimit të dëmtuesve në kohë.

### 7. Mundësia e keqpërdorimit në paraqitjen e të dhënave të rrejshme të cilësisë dhe sigurisë se prodhimeve dhe produkteve bujqësore

Mos harmonizimi i dispozitave ndëshkimore dhe afateve në përputhje me Ligjin e LPPA , Ligjin për Leje dhe Licenca dhe Ligjin për Kundërvajtje ndikon në mundësinë e paraqitjes së të dhënave të pasakta (të rrejshme).

### 8. Palët hasin barrë të lartë administrative gjatë qasjes në shërbimet relevante;

**Palët me interes – (përditësohet pas definimit të saktë të shkaqeve dhe efekteve)**

Pasqyrë e palëve të interesuara bazuar në përkufizimin e problemit

| **Emri i palës së interesuar** | **Shkaku/qet me të cilat është e lidhur pala** | **Efekti/et me të cilat është e lidhur pala** | **Mënyra me të cilën pala është e lidhur me këtë shkak (shkaqe) apo efektin (efektet)** |
|---|---|---|---|
| MBPZHR | 1. Korniza aktuale ligjore e pa harmonizuar me Rregulloren (BE) 2016/2031<br>2. Mos mbajtja e regjistrit fitosanitar per prodhim, paketim, përpunim, importim, eksportim, deponim, shpërndarjen e bimëve, produkteve bimore dhe objekteve tjera.<br>3.Mungesa e strategjive për identifikimin e sëmundjeve dhe dëmtuesve karantinor.<br>4. Mos-harmonizimi i dispozitave ndëshkimore. | 1. Mos zbatimi i standardeve të kërkuara nga BE sa i përket identifikimit dhe hulumtimit të sëmundjeve dhe dëmtuesve .<br>2. Krijimi i regjistrit fitosanitar për shëndetin bimor.<br>3. Mos menaxhimi i integruar i dëmtuesve, ka si pasojë uljen e prodhimit në kulturat bimore.<br>4. Mos rregullimi i kritereve dhe procedurave lidhur me masat ndaj personave fizik apo juridik të cilët veprojnë në kundërshtim me Ligjin për Mbrojtjen | MBPZhR-është përgjegjëse për hartimin e politikave dhe legjislacionit lidhur me shëndetin e bimëve. |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | e Bimëve. | |
| IBK | 1.Mungesa e strategjive për identifikimin e sëmundjeve dhe dëmtuesve karantinor. | 1.Strategjitë për menaxhimin e problemeve të Shëndetit të Bimëve. | IBK- është përgjegjës për realizimin e analizave dhe testimeve të sëmundjeve dhe dëmtuesve në bimë në bashkëpunim me AUV dhe MBPZHR. |
| Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës (AUV) | 1.Mungesa e rregullt e mbikëqyrjes nga shpërthimet e dëmtuesve të veçantë.<br><br>2. Mungesë e menaxhimit të integruar të sëmundjeve dhe dëmtuesve në bimë. | 1.Mbikëqyrje të rregullta për t'u mbrojtur nga shpërthimet e dëmtuesve të veçantë.<br><br>2. Mos menaxhimi i integruar i dëmtuesve ka si pasojë uljen e prodhimit në kulturat bimore. | AUV- është përgjegjës për zbatimin e politikave dhe legjislacionit të hartuar nga MBPZHR në funksion të kontrollit dhe monitorimit të shëndetit bimor. |

## Kapitulli 2: Objektivat

Objektivat relevante të Qeverisë

Siç është paraparë nga MSA-ja, Kosova ka zhvilluar Programin Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit (PKIE) si një dokument kryesor strategjik kombëtar për planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e zbatimit të të gjitha reformave të nevojshme për zbatimin e MSA-së dhe fazat e ardhshme të anëtarësimit në BE. PKIE për vitet 2021-2025 përcakton një kornizë gjithëpërfshirëse afatmesme të të gjitha reformave të kërkuara për të përmbushur detyrimet që dalin nga MSA-ja, përkatësisht masat dhe prioritetet e kërkuara për përafrimin e legjislacionit kombëtar me Acquis të BE-së. Bashkimi Evropian merr gjithashtu parasysh rekomandimet e dhëna çdo vit nga raportet e KE-së dhe për këtë arsye njeh rëndësinë e qasjes së integruar për shëndetin bimor, shëndetin e kafshëve dhe mirëqenies së kafshëve dhe sigurisë ushqimore.

Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2021-2025 është dokument bazë përmes të cilit Qeveria ua komunikon vizionin qytetarëve të Republikës së Kosovës në lidhje me qeverisjen e saj. Ai pasqyron qasjen dhe parimet që duhet ndjekur gjatë gjithë qeverisjes, si dhe prioritetet dhe nismat bazë që do të ndërmerren në të gjitha fushat për përmirësimin e situatës në vend. Ky

program pasqyron orientimet e përgjithshme në lidhje me agjendën e integrimit evropian dhe politikën e jashtme. Ai transmeton frymën demokratike dhe pluraliste të vendit, e cila siguron përfundimin e procesit të shtet ndërtimit dhe integrimin e plotë të Republikës së Kosovës në institucionet rajonale, evropiane dhe ndërkombëtare.

Sipas Programit Qeveritar 2021-2025 objektivi është avancimi i politikave të sigurisë ushqimore dhe harmonizimi i tyre me standardet e BE-së të cilat synojnë të sigurojnë një nivel të lartë të sigurisë së ushqimit, shëndetit të kafshëve dhe shëndetit të bimëve. Në këtë drejtim, prioritet do t'i ipet hartimit të kornizës ligjore për masat mbrojtëse kundër dëmtuesve të bimëve të Shëndetit Bimor**.** Qëllimet e politikave dhe objektivat strategjike janë tashmë të parapërcaktuara në dokumentet strategjike qeveritare, ndërsa objektivat specifike janë rezultat i përcaktimit të detajuar të problemit siç përshkruhet në Kapitullin 2 të këtij dokumenti pasi ato përcaktojnë objektivat konkrete që duhet arritur.

**Qëllimi i përgjithshëm, objektivi strategjik dhe objektivat specifike**

| **Qëllimi i përgjithshëm i politikës–Avancimi i politikave të Shëndetit të Bimëve në prodhimtarinë bujqësore për të siguruar prosperitet ekonomik të vendit** | |
|---|---|
| Objektivi strategjik:<br>Avancimi i politikave për siguri ushqimore dhe përafrimi i tyre me standardet e BE-së të cilat synojnë të sigurojnë nivel të lartë të ushqimit të sigurt për njeriun, kafshët dhe shëndetin e bimëve si dhe masat mbrojtëse kundër hyrjes së organizmave të dëmshëm për bimët ose produktet bimore.<br><br>Objektivat specifike:<br>1. Harmonizimi i legjislacionin vendor me legjislacion të BE-së (‘Acquis’) nga sektori i shëndetit të bimëve .<br>2.Ngritja e vetëdijes për rolin dhe rëndësinë e shëndetit të bimëve dhe mbrojtja e prodhimeve nga importimi dhe tregtimi i bimëve jo cilësore si dhe menaxhimi i sëmundjeve dhe dëmtuesve për të mbajtur bimët e shëndetshme dhe për mbrojtjen e mjedisit.<br>3. Tregtia e sigurt e bimëve dhe produkteve të tyre duke zbatuar standardet vendore dhe ndërkombëtare të shëndetit të bimëve.<br>4. Formimi i sistemeve të paralajmërimit për monitorim të hershëm për sëmundje dhe dëmtues për të mbrojtur shëndetin e bimëve.<br>5. Masat për parandalimin e hyrjes dhe përhapjes | -Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2021-2025<br>2.10. Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvillimi Rural<br><br>2.10.1 Reformat gjithëpërfshirëse institucionale dhe sektoriale për shërbime më efikase<br><br>2.10.2. Rritja e konkurrencës në sektorin agro-ushqimor<br><br>2.10.5 Siguria e ushqimit<br><br>-Plani Kombëtar për Zhvillim<br><br>Qëllimi Zhvillimor dhe qëllimi strategjik:<br>- 1.9 Ndërtimi i lidhjeve të qëndrueshme në mes të fermerëve, përpunuesve dhe shitësve me pakicë<br>-Masa Strategjike: Përmbushja e kërkesave për ushqimin të sigurt dhe të shëndetshëm<br>Aktiviteti– Hartimi i Koncept Dokumentit për Mbrojtjen e Bimëve |

| | |
|---|---|
| së organizmave të dëmshëm në bimë, produkte bimore dhe objekte tjera për menaxhimin dhe çrrënjosjen në kohë.<br>6. Grumbullimi dhe shkëmbimi i informacioneve dhe të dhënave me vendet tjera për sëmundjet dhe dëmtuesit<br>7. Krijimi i Regjistrit fitosanitar për prodhuesit, përpunuesit, importuesit dhe eksportuesit e bimëve;<br>8.Krijimi i listave të organizmave të dëmshëm për bimët, produktet bimore dhe objektet e tjera.<br>9.Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve, përmes zvogëlimit të barrës administrative për palët. | Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2030<br>Shtylla e I – Zhvillimi i Qëndrueshëm Ekonomik:<br>Qëllimi Zhvillimor: Ekonomi digjitale, qarkore dhe konkurruese.<br>Qëllimi Strategjik: 1.9 Ndërtimi i lidhjeve të qëndrueshme mes fermerëve, përpunuesve dhe shitësve me pakicë. |
| **Objektivat specifike Opsioni 2:**<br>1.Ngritja e kapaciteteve për zbatimin e Ligjit.<br>2.Mbrojtja e shëndetit të bimëve, kafshëve, njerëzve dhe mjedisit.<br>3.Ngritja e vetëdijes për rëndësinë e shëndetit bimor në kultura bujqësore.<br>4.Trajnim i inspektorëve fitosanitar për sëmundje dhe dëmtues.<br>5.Koordinim ndërinstitucional në mes MBPZHR, AUV-it, IBK-së, Fakulteteve të Bujqësisë relevante dhe palët e interesit me qëllim të harmonizimit dhe avancimit të politikave për sektorin e Shëndetit te Bimëve.<br>6.Vetëdijësimin e fermerëve përmes organizimit të kampanjës dhe sensibilizimit të institucioneve përgjegjëse për shëndetin e bimëve. | Të hartuara për nevojat e këtij KD |
| **Objektivat specifike Opsioni 3:**<br>1. Harmonizimi i ligjit për shëndetin e bimëve me Rregulloren e BE-së për Shendin e Bimëve 2016/2031<br>2.Ngritja e kapaciteteve për zbatimin e Ligjit dhe inspektimit të shëndetit te bimëve.<br>3.Krijimi i sistemit për trajnime të detyrueshme për mënyrën e identifikimit të sëmundjeve dhe dëmtuesve.<br>4. Krijimi i bazës së të dhënave për shëndetin e bimëve. | Të hartuara për nevojat e këtij KD |

**Praktikat e vendeve të rajonit lidhur me Shëndetin e Bimëve**

Shëndeti i Bimëve është zinxhir shumë i rëndësishëm në ruajtjen e shëndetit të njerëzve, kafshëve dhe mbrojtjen e mjedisit. Shtetet e regjionit dhe ata të BE-së bashkëpunojnë intenzivisht në të

gjitha fazat e proceseve integruese duke përafruar legjislacionin dhe ngritjen e cilësisë së shërbimeve përmes bashkëpunimit në nivel bilateral mes shteteve të regjionit, BE-së dhe institucioneve relevante profesionale në Shëndetin e Bimëve

***Shembulli i Republikës së Kroacisë***

Bazuar në Ligjin NR 127/2019 (27.12.2019), Ligji për shëndetin e bimëve i cili rregullon mbrojtjen e bimëve, produkteve bimore dhe objekteve të tjera nga organizmat e dëmshëm; përcaktimin e pranisë dhe përcaktimit të organizmave të dëmshëm; parandalimin e futjes dhe përhapjes së organizmave të dëmshëm dhe shtypjen dhe çrrënjosjen e tyre me zbatimin e masave sanitare, parandalimin e eksportit të bimëve, produkteve bimore dhe objekteve të tjera të infektuara me organizma të dëmshëm dhe mbrojtjen e mjedisit nga efektet e organizmave të dëmshëm. Ky ligj zbatohet për shëndetin e bimëve, sëmundjet dhe dëmtuesit, siç përcaktohet në nenin 3 paragrafi 1 deri 5.

KAPITULLI I.-Paraqet autoritetet kompetente dhe personat juridik me autoritetet publike
bazuar në Nenet 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11 dhe në paragrafët e këtyre neneve përfshihen ministria përgjegjëse për bujqësi, inspektoratet shtetërore, inspektoratet fitosanitare, pyjore, agjencionet dhe institutet.

KAPITULLI II.-Paraqet persona të tjerë juridik me autoritetet publike.

KAPITULLI III.-Detyrimet e subjekteve të specializuara dhe personave të tjerë. Neni 13 paragrafët 1,2,3 paraqesin subjektet e specializuara ku janë të detyruar të kontrollojnë bimët, produktet bimore dhe objektet e tjera të kujdesen për gjendjen e tyre shëndetësore dhe të zbatojnë masa për kontrollin e organizmave të dëmshëm duke marrë parasysh ndikimin e tyre ekonomik, social dhe mjedisor.

KAPITULLI IV.-Regjistri zyrtar i subjekteve të specializuara, Neni 14 paragrafi 1,2,3 dhe neni 15 me paragrafët 1.2.3 rregullon Regjistrin Zyrtar të Subjekteve të Specializuara.

KAPITULLI V.-Financimi, tarifa, shpenzimet dhe kompensimi. Neni 16. Financimi i punës së kryer nga organet kompetente dhe profesionale, neni 17 rregullon tarifat dhe shpenzimet në paragrafët 1.2,3,4,5 dhe paragrafi 6 Ministria e rregullon me Rregullore ndërsa neni 18 me paragrafët 1, nënparagrafet a), b) paragrafët 2,3,4,5,6,7,8 rregullon kompensimet. Një subjekt i specializuar ka të drejtën e kompensimit për bimët, produktet bimore dhe objektet e tjera që janë shkatërruar ose hequr nga zbatimi i masave fitosanitare të urdhëruara nga inspektori fitosanitar ose pyjor për shkak të shfaqjes së organizmave të dëmshëm në karantinë të Unionit.

KAPITULLI VI dhe VII përfshijnë mbikëqyrjen administrative dhe gjobat dhe KAPITULLI VIII dispozitat kalimtare dhe përfundimtare.

***Shembulli i Republikës së Shqipërisë***

Në kuadër të shembullit të një vendi nga regjioni është marrë Shqipëria e cila përmes Ligjit Nr. 105/2016 për Mbrojtjen e Bimëve (ndryshuar me ligjin nr. 15/2022, datë 3.2.2022), (i përditësuar).

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave. Ligjit Nr. 105/2016 për Mbrojtjen e Bimëve është një ligj i përbashkët me Mbrojtjen e Bimëve dhe Produktet për Mbrojtjen e Bimëve. Qëllimi i këtij ligji është: a) të mbrojë bimët dhe produktet bimore nga dëmtuesit; b) të parandaloj hyrjen dhe përhapjen e dëmtuesve në territorin e Republikës së Shqipërisë; c) të mbrojë shëndetin e njerëzve, kafshëve si dhe mjedisin nga përdorimi i produkteve për mbrojtjen e bimëve. **KREU II** rregullon organizimin dhe funksionimin e strukturave të mbrojtjes së bimëve, Neni 3 rregullon strukturat e mbrojtjes së bimëve, neni 4 ,detyrat e strukturave të mbrojtjes së bimëve, Neni 5 Laboratorët kombëtarë të references, Neni 6/1 Regjistri i operatorëve profesionistë (shtuar me ligjin nr. 15/2022, datë 3.2.2022) Regjistri i operatorëve profesionistë mbahet në AKVMB. Formati, kriteret dhe procedura e regjistrimit përcaktohen me udhëzim të ministrit.
KREU III. Kontrolli i dëmtuesve ,Neni 7, Detyrimi për kontrollin e dëmtuesve me paragraf dhe nënparagraf, neni 8 masat e veçanta të kontrollit të dëmtuesve me paragraf, neni 9 me paragrafët 1 dhe 2, neni 10 zonat e pastra paragrafi 1,2,3,4,5, neni 11 kërkesat fitosanitare ndaj paletave dhe materialit të ambalazhit prej drurit me paragrafët 1,2,3,4, neni 12 pasaportat bimore me paragrafët 1,2,3,4,5,6 dhe neni 13 fondet për mbrojtjen e bimëve rregullohen me paragrafët 1,2,3.
KREU IV. Shërbimi dhe inspektimi fitosanitar përfshihen këto nene me paragraf, Neni 14, Detyrimi për inspektimin dhe kontrollin fitosanitar rregullohet me paragrafët 1,2,3,4,5,6,7,8,9, neni 15, njoftimi i shërbimit të mbrojtjes së bimëve rregullohet me paragrafët 1,2,3,4,5, neni 16, shpallja e zonës së shënuar, neni 17 Shumëzimi i dëmtuesve për qëllime kërkimore dhe neni 18, për eksportin.
KREU VI.Kundërvajtjet Administrative; Neni 29 procedurat e kundërvajtjeve, të drejtën e dhënies së masës administrative si e përcakton Neni 28 i këtij ligji e ka inspektori i organit të kontrollit.
KREU VII.Dispozitat e fundit dhe kalimtare; Neni 30 Dispozitë kalimtare 1. Laboratorët e diagnostikimit të dëmtuesve të Departamentit të Mbrojtjes së Bimëve pranë Universitetit Bujqësor të Tiranës, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, riorganizohen si institucion në varësi të ministrit. 2.Mënyra e organizimit dhe funksionimit të laboratorëve të diagnostikimit të dëmtuesve të Departamentit të Mbrojtjes së Bimëve përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Neni 31 Akte nënligjore 1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të pikës 5, të nenit 14; të pikës 4, të nenit 19; të pikës 7, të nenit 20; të pikës 6, të nenit 23 dhe pikës 2, të nenit 30, të këtij ligji. 2. Ngarkohet ministri të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të pikave 2, 3 dhe 4, të nenit 6; të pikave 2 e 7, të nenit 7; të pikave 1 e 3, të nenit 8; të pikave 2 e 3, të nenit 10; të pikave 1 e 3, të nenit 12; të pikave 2 e 3, të nenit 13; të pikës 3, të nenit 15; të pikës 2, të nenit 17; të pikës 5, të nenit 19; të pikës 7, të nenit 23; dhe të pikës 4, të nenit 24 të këtij ligji. 3. Ngarkohen ministri dhe ministria përgjegjëse për mjedisin të nxjerrin aktin nënligjor në zbatim të pikës 4, të nenit 10, dhe pikës 4, të nenit 11, të këtij ligji.

***Shembulli i Republikës së Sllovenisë***

Bazuar ne Ligjin për Shëndetin e Bimëve dhe Nr.62/07, plotësim ndryshimi i disa neneve te publikuara në gazetën zyrtare, 36/10 e datës 4 maj 2010, Nr.40/14, 3 qershor 2014, Nr. 21/18, datë 30.03.2018. Ky ligj ka për qëllim mbrojtjen e bimëve dhe produkteve bimore nga organizmat e dëmshëm; parandalimi i futjes, përhapjes dhe frenimit të organizmave të dëmshëm duke siguruar masa fitosanitare; identifikimi dhe përcaktimi i organizmave të dëmshëm; mundëson prodhimin dhe tregtimin optimal të bimëve; mbrojtja e mjedisit, e natyrës dhe rrjedhimisht e shëndetit të njeriut duke kryer kontroll të vazhdueshëm të organizmave të dëmshëm, duke futur mbrojtjen biotike të bimëve dhe duke vëzhguar e parashikuar aktivitete; drejtimin dhe monitorimin e zhvillimit të aktiviteteve për mbrojtjen e shëndetit të bimëve; kujdeset për edukimin dhe ndërgjegjësimin e popullatës për mbrojtjen e shëndetit të bimëve.

KAPITULLI I. Përfshinë dispozitat e përgjithshme ku hynë qëllimi i ligjit, detyrat, organet zyrtare përgjegjëse si dhe termet.

KAPITULLI II. Paraqet kujdesin shëndetësor të bimëve dhe rregullohet me Nenin 4,5,6.

KAPITULLI III.Rregullon parandalimi e hyrjes, përhapjes dhe kontrollit të organizmave të dëmshëm përmes neneve 7, 8, 9, 10, 11, 12,12a,12b,13,14,15,16,17,18,19,20,21,22,23. Si dhe në këtë kapitull rregullohen importi nga vendet e treta, eksporti dhe transiti i dërgesave, lëvizja e bimëve, produkteve bimore dhe objekteve të kontrolluara. Te lëvizja e bimëve hyjnë nenet që i rregullojnë zonat e mbrojtura ,pasaportën bimore, prodhimin, përpunimin dhe përdorimin etj.

KAPITULLI IV. Mbrojtja biotike e bimëve rregullohet me nenin 51 mbrojtja biotike e bimëve, Neni 52 llojet autoktone të organizmave dhe Neni 53 llojet jo-vendase të organizmave.

KAPITULLI V. Përdorimi dhe shkëmbimi i të dhënave dhe informacionit ku Neni 54 rregullon marrjen dhe përdorimin e të dhënave, Neni 55 transferimi i të dhënave Neni 56 Sistemi informativ dhe Neni 57 shkëmbimi ndërkombëtar i të dhënave dhe informacionit.

KAPITULLI VI. Kostot, tarifa dhe bashkëfinancimi i programit

KAPITULLI VII. Kompensimi

KAPITULLI VIII. Shërbimi publik i mbrojtjes së shëndetit të bimëve

KAPITULLI IX. Pushtetet Publike

KAPITULLI X. Organizatat joqeveritare në interes publik në fushën e mbrojtjes së shëndetit të bimëve.

KAPITULLI XI. Këshilli i ekspertëve për kujdesin shëndetësor të bimëve.

KAPITULLI XII. Kompetenca dhe organet shtetërore. Në këtë kapitull hyn qeveria, ministri, administrata dhe mbikëqyrja inspektuese.

KAPITULLI XIII. Bashkëpunimi me autoritetet kompetente të komunitetit.

KAPITULLI XIV. Bashkëpunimi me autoritetet e komunitetit vendor.

KAPITULLI XV. Dispozitat penale.

KAPITULLI XVI. Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare.

## Kapitulli 3: Opsionet

### 3.1: Opsioni asnjë ndryshim

Opsioni i parë është që të vazhdohet me zbatimin e politikës dhe kornizës ligjore aktuale për Shëndetin e Bimëve, por zbatimi i këtij ligji në praktikë është sfidues për MBPZhR-në. Me vazhdimin e opsionit pa ndryshime do të vazhdojnë problemet e cekura më lartë mbi masat mbrojtëse kundër sëmundjeve dhe dëmtuesve në shëndetin bimor. Gjithashtu dhe definimi jo i qartë i kompetencave në mes nivelit qendror dhe atij lokal, mungesa e mbikëqyrjes adekuate të zbatimit të Ligjit.

Sa i takon barrës administrative, ky opsion nuk parasheh masa të reja për përmirësimin e ofrimit të shërbimeve, andaj supozohet që barra administrative mbetet e njëjtë.

### 3.2. Opsioni për përmirësimin e zbatimit dhe ekzekutimit

Ky opsion parasheh plotësim-ndryshimin e Ligjit për Mbrojtje të Bimëve i cili do të eliminonte shkaqet dhe efektet e cekura të definimi të problemit.
MBPZHR-Departamenti për Politika Bujqësore dhe Tregje - Divizioni i Mbrojtjes së Bimëve është përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Mbrojtje të Bimëve përmes inspektorëve fitosanitar. Aktualisht, numri i inspektorëve është i kufizuar për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit të Mbrojtjes së Bimëve.

Për përmirësimin e menaxhimit të qëndrueshëm të Mbrojtjes se Bimëve Opsioni 2 parasheh të ndërmerren këto masa:

- Rritjen e buxhetit për rritjen e numrit të inspektorëve fitosanitar në nivelin qendror dhe komunal;
- Koordinim më të mirë ndërinstitucional në mes të nivelit qendror dhe lokal (MBPZHR, MMPHI, MAPL, komunat) për harmonizimin e politikave në menaxhimin e Mbrojtjes së Bimëve;
- Trajnimet dhe ngritja e kapaciteteve të stafit;
- Vetëdijesimin e popullatës përmes organizimit të kampanjës dhe sensibilizimit të institucioneve përgjegjëse.
- Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve përmes përpjekjeve për thjeshtim brenda kornizës së tanishme ligjore, si dhe përmes rritjes së përpjekjeve për trajnim dhe ri-organizim të kornizës institucionale për ofrim të shërbimeve.

### 3.3. Opsioni i tretë me ndryshime

Projektligji për Shëndet të Bimëve adreson çështjet që janë të parregulluara apo kanë zbrazëtira juridike. Duke parë gjendjen e tanishme në zbatimin e kornizës ligjore është paraparë hartimi i Ligjit të ri për Shëndetin e Bimëve për shkak të direktivave të shfuqizuara dhe fuqizimit të rregulloreve të reja.

Sipas këtij opsioni, Projektligji do të përcaktonte parimet dhe objektivat për politikat e Shëndetit të Bimëve që kërkohen për të arritur rezultatet e dëshiruara dhe qasje gjithëpërfshirëse. Të gjitha standardet lidhur me Shëndetin e Bimëve do të harmonizohen me standardet ndërkombëtare të BE-së ashtu dhe Organizatën Evropiane për Mbrojtjen e Bimëve (OEMB).

Projektligji i ri për Shëndetin e Bimëve krijon rregulla të reja ligjore për harmonizimin dhe standardizimin për masat mbrojtëse kundër dëmtuesve dhe sëmundjeve të bimëve në kulturat bujqësore dhe ruajtjen e mjedisit.

Me këtë opsion do të bëhet dhe më shumë përafrimi i rregullave dhe direktivave të Acquis të BE-së për Shëndetin e Bimëve, do të na mundësoj zbatimin e akteve ligjore primare dhe sekondare.

Përmes kësaj politike synohet efikasiteti dhe efektiviteti më i madh i krijimit të politikave bujqësore për Shëndetin e Bimëve.

Ndër objektivat kryesore janë harmonizimi i legjislacionit me Acquis e BE-së, krijimi i kornizës ligjore për zbatimin e afateve të përcaktuara me Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe sanksioneve me Ligjin për Kundërvajtje si dhe përfaqësimi më efikas i interesave të fermerëve dhe shoqatave në cilësinë e ushqimit dhe mbrojtjes së mjedisit.

Të gjitha këto ndryshime planifikohen të arrihen duke filluar nga viti 2025, ndërsa përgjegjës kryesor do të jetë Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe të gjitha organet tjera relevante në nivel qendror dhe komunal për vendosjen e rregullave të Shëndetit të Bimëve dhe sistemin e tyre rregullues.

**Projektligji i ri për Shëndetin e Bimëve të përfshijë elementet themelore si në vijim:**

- Krijimin dhe mbajtjen e regjistrit fitosanitar për prodhim, paketim, përpunim, importim, eksportim, deponim, shpërndarjen e bimëve, produkteve bimore dhe objekteve tjera. Do të krijohet një bazë elektronike e të dhënave në të cilën do të regjistrohen të gjithë personat juridik dhe fizik për prodhim, paketim, përpunim, importim, eksportim, deponim, shpërndarjen e bimëve, produkteve bimore dhe objekteve tjera.

- Shkëmbehen informacione në lidhje me shëndetin e bimëve në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

- Kryerja e analizave dhe vlerësimi i gjendjes shëndetësore të bimëve; Do të bëhet në laboratorin e IBK-së dhe në laboratoret e tjera të licencuar dhe akredituara për vlerësimin e gjendjes shëndetësore të bimëve.
- Zbatimi i një sistemi pasaportash bimore plotësisht në përputhje me kërkesat e BE-së; Pasaporta bimore do të jetë një etiketë zyrtare për lëvizjen e bimëve, produkteve bimore dhe objekteve të tjera brenda territorit të BE-së kur është e aplikueshme dhe brenda

zonave të mbrojtura, e cila vërteton pajtueshmërinë me të gjitha kërkesat e përcaktuara në nenin 85 për lëvizjen në dhe brenda zonave të mbrojtura, neni 86 ka përmbajtjen dhe formatin e përcaktuar në nenin 83.

- Autorizimi i një ndërmarrje për lëshimin e pasaportave të bimëve; Pasaportat e bimëve lëshohen nga operatorë të autorizuar nën mbikëqyrjen e autoriteteve kompetente. Operatorët e autorizuar lëshojnë pasaporta bimore vetëm për bimët, produktet bimore ose objektet e tjera për të cilat ata janë përgjegjës. Me përjashtim të paragrafit 1, autoritetet kompetente mund të lëshojnë dhe pasaporta bimore. Operatorët e autorizuar lëshojnë pasaporta bimore vetëm në ambientet, magazinat kolektive dhe qendrat dispeçeruese që janë nën përgjegjësinë e tyre dhe të deklaruara prej tyre në përputhje me pikën (d) të nenit 66(2) ose kur zbatohet neni 94 (1) në një vend tjetër nëse autorizohet nga autoriteti kompetent.

- Zbatimi i mbikëqyrjes së intensifikuar të dëmtuesve, prioritetet dhe të tjerë karantinë (përfshirë marrjen e mostrave dhe monitorimin e vektorëve);

- Ofrimi i këshillave dhe hulumtimeve shkencore nga ekspertët përkatës për sëmundjet dhe dëmtuesit e bimëve duke mundësuar ruajtjen e shëndetit të bimëve (Do të bëhet përmes sistemit te shërbimit këshillimor publik i cili është i organizuar brenda MBPZHR (Departamenti për Shërbime Këshillimore dhe Teknike) dhe zyret informative këshilluese të cilat gjinden në kuvendet komunale të komunave të Kosovës. Gjithashtu, ekziston dhe sektori privat i shërbimit këshillimor (specialist dhe ekspert profesional) duke përfshirë edhe fakultetet përkatëse për bujqësi,

- Trajnime profesionale dhe teknike për diagnostifikimin e sëmundjeve dhe dëmtuesve për inspektorim fitosanitar;

- Mënyrën e monitorimit dhe menaxhimit të integruar të sëmundjeve dhe dëmtuesve do të krijohet një udhëzues për mënyrën e monitorimit të integruar të sëmundjeve dhe dëmtuesve i cili do të specifikoj të gjitha procedurat për monitorim;

- Standardi Ndërkombëtar për Masat Fitosanitare Nr.15 Rregullorja e Materialit të Paketimit të Drurit në Tregtinë Ndërkombëtare (ISPM15). Kërkon që materiali i paketimit të drurit të shënohet me një shenjë specifike të aplikuar nga operatorë profesionistë të autorizuar dhe të mbikëqyrur siç duhet. Kjo rregullore duhet të përcaktoj kërkesat në lidhje me trajtimin, shënjimin dhe riparimin e materialit të paketimit të drurit në përputhje me atë standard. Kjo rregullore duhet gjithashtu të përcaktojë rregulla për autorizimin dhe mbikëqyrjen e operatorëve profesionistë në territorin e Bashkimit që e aplikojnë atë markë.

- Ligji i ri do të harmonizohet plotësisht me kërkesat e LPPA, sidomos sa i takon zbatimit të parimit 'vetëm një herë'. Tutje, Ligji i ri do të ofroj kornizë për harmonizim me afatet dhe parimin e mos pagesës.

Ky opsion krijon kornizën adekuate ligjore për shëndetin e bimëve të harmonizuar me Acquis të BE-së, parakusht për zbatimin e masave për shëndetin e bimëve në përputhje me objektivat e kornizës së re legjislative të BE-së për përgatitjen e programeve në fushën e shëndetit të bimëve. Gjithashtu, mundëson tregtinë e sigurt vendore dhe ndërkombëtare të bimëve, produkteve bimore. Megjithëse, korniza e përgjithshme legjislative mund të mos përmbajë dispozita të hollësishme dhe specifike legjislative. Këto rregulla do të përcaktohen në një fazë të mëvonshme me anë të legjislacionit dytësor.

Sa i takon barrës administrative, përveç harmonizimit me legjislacionin për procedurat e përgjithshme administrative do të sigurojmë masa specifike për thjeshtim dhe digjitalizim të shërbimeve publike.

**Praktikat e vendeve të rajonit, të cilat mund të gjejnë zbatim në Republikën e Kosovës dhe të cilat do të merren parasysh gjatë hartimit të Projektligjit janë:**

***<u>Praktikat e Republikës së Shqipërisë:</u>***

Në kuadër të shembullit të një vendi nga regjioni është marrë Shqipëria e cila përmes Ligjit Nr. 105/2016 për Mbrojtjen e Bimëve (ndryshuar me ligjin nr. 15/2022, datë 3.2.2022), (i përditësuar). Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave. Ligjit Nr. 105/2016 për Mbrojtjen e Bimëve është një ligj i përbashkët me Mbrojtjen e Bimëve dhe Produktet për Mbrojtjen e Bimëve. Qëllimi i këtij ligji është: a) të mbrojë bimët dhe produktet bimore nga dëmtuesit; b) të parandaloj hyrjen dhe përhapjen e dëmtuesve në territorin e Republikës së Shqipërisë; c) të mbrojë shëndetin e njerëzve, kafshëve, si dhe mjedisin nga përdorimi i produkteve për mbrojtjen e bimëve.
**KREU III**. Kontrolli i dëmtuesve ,Neni 7, Detyrimi për kontrollin e dëmtuesve me paragraf dhe nënparagraf ,neni 8 masat e veçanta të kontrollit të dëmtuesve me paragraf, neni 9 me paragrafët 1 dhe 2,neni 10 zonat e pastra paragrafi 1,2,3,4,5, neni 11 kërkesat fitosanitare ndaj paletave dhe materialit te ambalazhit prej drurit me paragrafët 1,2,3,4, neni 12 pasaportat bimore me paragrafët 1,2,3,4,5,6 dhe neni 13 fondet për mbrojtjen e bimëve rregullohen me paragrafët 1,2,3. KREU IV. Shërbimi dhe inspektimi fitosanitar përfshihen këto nene me paragraf, Neni 14, Detyrimi për inspektimin dhe kontrollin fitosanitar rregullohet me paragrafët 1,2,3,4,5,6,7,8,9, neni 15, njoftimi i shërbimit të mbrojtjes së bimëve rregullohet me paragrafët 1,2,3,4,5, neni 16, shpallja e zonës së shënuar, neni 17 Shumëzimi i dëmtuesve për qëllime kërkimore dhe neni 18, për eksportin.
KREU VI—Kundërvajtjet Administratve; NENI 29 procedurat e kundërvajtjeve, të drejtën e dhënies se masës administrative si e përcakton Neni 28 i këtij ligji e ka inspektori i organit të kontrollit.

***Praktikat e Republikës së Kroacisë:***

Bazuar ne Ligjin NN 127/2019 (27.12.2019), Ligji për shëndetin e bimëve i cili rregullon mbrojtjen e bimëve, produkteve bimore dhe objekteve të tjera nga organizmat e dëmshëm; përcaktimin e pranisë dhe përcaktimit të organizmave të dëmshëm; parandalimin e futjes dhe përhapjes së organizmave të dëmshëm, shtypjen dhe çrrënjosjen e tyre me zbatimin e masave sanitare, parandalimin e eksportit të bimëve, produkteve bimore dhe sendeve të tjera të infektuara me organizma të dëmshëm dhe mbrojtjen e mjedisit nga efektet e organizmave të dëmshëm. Ky ligj zbatohet për Shëndetin e Bimëve që janë sëmundjet dhe dëmtuesit, siç përcaktohet në nenin 3 paragrafi 1 deri 5.

KAPITULLI I. Paraqet autoritetet kompetente dhe personat juridik me autoritetet publike

Bazuar ne Nenet 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11 dhe paragrafët e këtyre neneve përfshihen ministria përgjegjëse për bujqësi, inspektoratet shtetërore, inspektoratet sanitare, pyjore ,agjencionet dhe institutet.

KAPITULLI II. Paraqet persona të tjerë juridik me autoritetet publike.

KAPITULLI III. Detyrimet e subjekteve të specializuara dhe personave të tjerë. Neni 13 paragrafët 1,2,3 paraqesin subjektet e specializuar ku janë të detyruar të kontrollojnë bimët, produktet bimore dhe objektet e tjera, të kujdeset për gjendjen e tyre shëndetësore dhe të zbatoj masa për kontrollin e organizmave të dëmshëm duke marrë parasysh ndikimin e tyre ekonomik, social dhe mjedisor.

KAPITULLI IV. Regjistri zyrtar i subjekteve të specializuara, Neni 14 paragrafi 1,2,3 dhe neni 15 me paragrafët 1.2.3 e rregullon Regjistrin Zyrtar të Subjekteve të Specializuara.

KAPITULLI V. Financimi, tarifa, shpenzimet dhe kompensimi. Neni 16. Financimi i punës së kryer nga organet kompetente dhe profesionale, neni 17 rregullon Tarifat dhe shpenzimet në paragrafët 1.2,3,4,5 dhe paragrafi 6 Ministria e rregullon me rregullore, ndërsa neni 18, me paragrafët 1, nënparagrafet a),b) paragrafët 2,3, 4,5,6,7,8 rregullon kompensimet. Një subjekt i specializuar ka të drejtën e kompensimit për bimët, produktet bimore dhe objektet e tjera që janë shkatërruar ose hequr nga zbatimi i masave fitosanitare të urdhëruara nga inspektori fitosanitar ose pyjor për shkak të shfaqjes së organizmave të dëmshëm në karantinë të Unionit.

KAPITULLI VI dhe VII përfshijnë mbikëqyrjen administrative dhe gjobat.

KAPITULLI VIII përfshin dispozitat kalimtare dhe përfundimtare.

***Praktikat e Republikës së Slovenis***ë

Bazuar ne Ligjin për Shëndetin e Bimëve dhe Nr.62/07, plotësim ndryshimi i disa neneve të publikuara në Gazetën Zyrtare, 36/10 e datës 4 maj 2010, Nr.40/14, 3 qershor 2014, Nr. 21/18, datë 30.03.2018. Ky ligj ka për qëllim, mbrojtjen e bimëve dhe produkteve bimore nga organizmat e dëmshëm; parandalimi i futjes dhe përhapjes, frenimit të organizmave të dëmshëm duke siguruar masa fitosanitare; identifikimi dhe përcaktimi i organizmave të dëmshëm;

mundëson prodhimin dhe tregtimin optimal të bimëve me to; mbrojtja e mjedisit, e natyrës dhe rrjedhimisht e shëndetit të njeriut duke kryer kontroll të vazhdueshëm të organizmave të dëmshëm, duke futur mbrojtjen biotike të bimëve dhe duke vëzhguar e parashikuar aktivitete; drejtimin dhe monitorimin e zhvillimit të aktiviteteve për mbrojtjen e shëndetit të bimëve; kujdeset për edukimin dhe ndërgjegjësimin e popullatës për mbrojtjen e shëndetit të bimëve.

**KAPITULLI II**. Paraqet kujdesin shëndetësor të bimëve dhe rregullohet me Nenet 4,5,6.

KAPITULLI III. Rregullon parandalimi e hyrjes, përhapjes dhe kontrollit të organizmave të dëmshëm përmes neneve 7, 8, 9, 10, 11, 12,12a,12b,13,14,15,16,17,18,19,20,21,22,23. Si dhe ne këtë kapitull rregullohen importi nga vendet e treta, eksporti dhe transiti i dërgesave, lëvizja e bimëve, produkteve bimore dhe objekteve të kontrolluara. Te lëvizja e bimëve hyjnë nenet që i rregullojnë zonat e mbrojtura, pasaportën bimore, prodhimin, përpunimin, përdorimin etj.

KAPITULLI IV. Mbrojtja biotike e bimëve rregullohet me nenin 51 mbrojtja biotike e bimëve, Neni 52 llojet autoktone të organizmave dhe Neni 53 llojet jo-vendase të organizmave.

KAPITULLI V. Përdorimi dhe shkëmbimi i të dhënave dhe informacionit ku Neni 54 rregullon marrjen dhe përdorimin e të dhënave, Neni 55 transferimi i të dhënave Neni 56 Sistemi informativ.Neni 57-shkëmbimi ndërkombëtar i të dhënave dhe informacionit.

KAPITULLI VI. Kostot, tarifa dhe bashkëfinancimi i programit.

KAPITULLI VII. Kompensimi.

KAPITULLI VIII. Shërbimi publik i mbrojtjes së shëndetit të bimëve

KAPITULLI IX-Pushtetet Publike

KAPITULLI X. Këshilli i ekspertëve për kujdesin shëndetësor të bimëve.

KAPITULLI XI.B Bashkëpunimi me autoritetet e komunitetit vendor.

**Kapitulli 4: Identifikimi dhe vlerësimi i ndikimeve të ardhshme**

**Ndikimet më të rëndësishme të identifikuara për kategorinë e ndikimit**

| **Kategoritë e ndikimeve** | **Ndikimet përkatëse të identifikuara** |
|---|---|
| **Ndikimet ekonomike** | Ndikim në qasjen në financa për biznes;<br>Largohen nga tregu produkte të caktuara (jo cilësore);<br>Lejohen në treg produkte të caktuara (cilësore);<br>Do të krijohen biznese të reja. |
| Ngarkesa administrative | Pritet që ky KD të ketë ndikim pozitiv sa i takon ofrimit të shërbimeve, përmes thjeshtimit dhe digjitalizimit të tyre. Masa të tilla pritet të ulin barrën administrative për palët. |
| Tregtia | Ndryshim në flukset aktuale të importit. |
| Investimet | Pritje nga kompanitë të investojnë në veprimtari të reja;<br>Rritje e investimeve nga diaspora;<br>Rritje e investimeve të huaja direkte. |
| Konkurrueshmëria | Promovim i inovacionit dhe hulumtimit. |
| Ndikimet ekonomike rajonale | Ndikim në sektor të veçantë të biznesit. |

| | |
|---|---|
| Zhvillimi i përgjithshëm ekonomik | Ndikim në rritjen e ardhshme ekonomike. |
| Ndikimet shoqërore | Ndikim në arsimimin e punëtorëve dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës. |
| Qeverisja | Trajtimi i çdo personi në mënyrë të barabartë;<br>Informim më mirë i publikut në lidhje me çështje të caktuara. |
| Shëndeti dhe siguria publike[1] | Ndikim në jetën e njerëzve, siç është jetëgjatësia apo shkalla e vdekshmërisë;<br>Ndikim në cilësinë e ushqimit. |
| Ndikimet mjedisore<br>Mirëqenia e njeriut | Ndikim në shëndetin e njerëzve dhe ruajtjes së mjedisit më të pastër;<br>Ndikim në cilësinë dhe sigurinë e ushqimit të njerëzve. |
| Ndikimi në të drejtat themelore<br>Trajtimi i barabartë | Ndikim në mbrojtjen e opsionit për parimin e barazisë para ligjit. |
| Administrimi i mirë | Ndikohet mënyra në të cilën administrata merr vendime (transparenca, afati procedural, e drejta për qasje në një dosje, etj.). |

**NDIKIMET EKONOMIKE**

## Ndikimi në qasjen në financa për biznes

Me vendosjen e këtyre politikave apo me hartimin e Ligjit të ri të Shëndetit të Bimëve synohet përmirësimi i shëndetit të bimëve në kultura bimore nga dëmtuesit, sëmundjet të cilat pa dyshim do të kenë efekt në ruajtjen e shëndetit të njeriut, kafshëve dhe bimëve. Me këtë politikë një pjesë e produkteve bujqësore do të jenë konkurruese në treg për nga aspekti i cilësisë dhe sigurisë ushqimore.

## Shëndeti i bimëve

Mbajtja e bimëve të shëndetshme është thelbësore për produktivitetin bujqësor dhe prodhimin e ushqimit. Në fakt, bimët kanë një ndikim të dyfishtë në furnizimet me ushqim-drejtpërdrejtë, kur ne konsumojmë bimët dhe indirekt kur përdorim bimët si ushqim për kafshët e fermës. Kjo nga ana tjetër mund të rezultoj në çmime më të larta të ushqimeve për konsumatorët dhe potencialisht të krijojë mungesa ushqimore, duke ndikuar në ekonominë e përgjithshëm shëndeti i bimëve është gjithashtu i lidhur ngushtë me tregtinë ndërkombëtare.

## Sëmundjet dhe dëmtuesit e bimëve

Sëmundjet dhe dëmtuesit e bimëve mund të shkatërrojnë të korrat duke çuar në ulje të rendimenteve dhe rritje të kostove të prodhimit për fermerët. Dëmtuesit dhe sëmundjet invazive mund të futen përmes lëvizjes së bimëve dhe produkteve bimore përtej kufijve, duke ndërprerë tregtinë dhe duke shkaktuar humbje ekonomike. Mbrojtja e shëndetit të bimëve nëpërmjet akteve

[1] Kur ka ndikim në shëndet publik dhe siguri, atëherë rregullisht ka ndikime mjedisore.

nënligjore ndihmon në mbrojtjen e bujqësisë vendore dhe parandalimin e përhapjes së dëmtuesve dhe sëmundjeve.

**Krijimi i bizneseve të reja**

Krijimi i bazës ligjore duke e harmonizuar me standardet e BE mundëson dhe krijimin e bizneseve të reja që merren me tregtimin e produkteve cilësore për mbrojtjen e kulturave bimore nga sëmundjet dhe dëmtuesit.

**Dhënia e informatave për bizneset**

Dhënia e informatave për bizneset lidhur me të gjitha procedurat dhe kriteret për regjistrimin në regjistrin bimor do të ketë shumë efekte pozitive për arsye se përcjellët gjendja shëndetësore e bimëve dhe produkteve bimore.

**Ndryshueshmëria e flukseve aktuale të importit**

Ndryshimi i fluksit të importit aktual të bimëve do të jetë i mundur duke u mbështetur importuesit dhe tregtuesit vendor të cilët do të mund t'i furnizojnë fermerët me bimë cilësore që japin efekt në prodhim me cilësi të lartë.

**Investimet e kompanive në veprimtari të reja**

Të gjitha kompanitë prodhuese apo përpunuese për shëndetin e bimëve pritet të investojnë në produkte të reja dhe të shëndetshme.

**Investimet nga diaspora**

Përmes rrugës ligjore me hartimin e Ligjit të ri për Shëndetin e Bimëve, do të krijohen hapësira për palët që kanë për synim investimet në zhvillimin e sektorit të shëndetit të bimëve në vendin tonë, të cilat mund të jenë dhe operatorë të jashtëm nga diaspora të cilët do ta kenë mundësinë e investimeve në sektorin e importimit dhe tregtimit të bimëve dhe produkteve bimore. Investimet në sektorin e shëndetit bimor nga diaspora në vendin tonë do të kenë ndikim në ngritjen e standardeve të cilësisë për importimin dhe tregtimin e bimëve, produkteve bimore duke u bazuar në praktikat e vendeve të ndryshme të botës nga të cilat vijnë investitorët.

**Investimet e huaja direkte**

Investimet e huaja në sektorin e Shëndetit të Bimëve do të jenë të mundshme, sepse aktualisht është e pamundshme mbulimi i tregut tonë me bimë dhe produkte bimore, andaj kjo gjendje mund të nxitë kompanitë e huaja importuese dhe tregtuese të bimëve dhe produkteve bimore të realizojnë investime direkte në vendin tonë.

**Promovimi i inovacionit dhe hulumtimi**

Hulumtimi dhe identifikimi i dëmtuesve dhe sëmundjeve do të realizohet përmes analizave laboratorike si dhe do të krijohen mundësi për promovimin e gjendjes shëndetësore përmes shërbimeve këshillimore tek operatorët bujqësor dhe fermerët .

**Ndikimi në sektorë të biznesit**

Përmirësimi i rregullativës ligjore për shëndetin e bimëve krijon mundësi për zhvillimin e suksesshëm të sektorit të Shëndetit të Bimëve duke i krijuar hapësirë bizneseve që importojnë dhe tregtojnë bimë cilësore për fermerët të cilët do të ndikojnë në zhvillimin e suksesshëm të bizneseve në sektorin përkatës.

**Ndikimi në rritjen e ardhshme ekonomike**

Shëndeti i bimëve në kulturat bujqësore do të ketë ndikim në zhvillimin ekonomik në nivel vendi duke pasur efekt në ndikimin e rritjes së prodhimtarisë bimore në vendin tonë.

**BARRA ADMINISTRATIVE**

Siç u përmend ky KD dhe legjislacioni që do të derivojë nga ai, do të ulë barrën administrative gjatë ofrimit të shërbimeve sa i takon shëndetit të bimëve. Ndikimet kryesore do të reflektohen në zvogëlimin e kostos dhe shkurtimin e kohës për palët gjatë marrjes së shërbimeve që mbulon ky KD.

**NDIKIMET SHOQËRORE**

**Ndikimi në arsimim**

Zhvillimi dhe arsimimi i stafit profesional dhe teknik do të mund të plotësohet përmes ndjekjes së trajnimeve të organizuara nga institucione përkatëse me qëllim përgatitjen e kuadrove profesionale të cilat do të japin kontributin e tyre në zhvillimin e sektorit të SHB-ve në të ardhmën.

**Trajtimi dhe barazia e individëve**

Personat fizik apo juridik të cilët do të merren me importimin apo tregtimin e bimëve, produkteve bimore, do të jenë të barabartë pa dallime gjinore, përkatësie etnike apo religjioni duke i respektuar rregullat që do të përcaktohen në Ligjin e MB-ve.

**Informimi i publikut**

Të gjitha palët e interesuara (publiku) do të jenë të informuar me rregullat apo kriteret të cilat do të paraqiten në Ligjin e ri për Shëndetin e Bimëve, i cili do të jetë i publikuar në ueb faqen zyrtare të MBPZhR-së si dhe Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Ndikimi në jetën e njerëzve**

Prodhimi dhe furnizimi i fermerëve me bimë dhe produkte bimore cilësore nënkupton përdorimin efikas të produkteve me vlera cilësore që ndikon në zinxhirin ushqimor, të cilat produkte bimore padyshim kanë ndikim në ushqyerjen e shëndetshme të popullatës dhe ndikim të jetëgjatësisë.

**Ndikimi në cilësinë e ushqimit**

Nga produktet e fituara do të ketë ndikim në sigurimin e ushqimit primar për popullatën dhe sigurinë e cila ndikon në shëndetin e përgjithshëm publik që nënkupton se është interes nacional në vendin tonë.

**NDIKIMET MJEDISORE**

Përdorimi i vazhdueshëm i PMB-ve për shëndetin e bimëve dhe produktet bimore ka ndikim në ndotjen e tokës dhe ujit, si pasojë e akumulimit të mbetjeve kimike të cilat mund ta ndryshojnë ekosistemin.

**Ndikimi në cilësinë dhe sigurinë e ushqimit**

Monitorimi dhe menaxhimi i dëmtuesve si dhe kontrolli i PMB-ve në treg, nënkupton sigurimin e shëndetit cilësor të bimëve nga të cilat do të fitohen produkte të shëndetshme bimore me vlera të larta ushqyese të cilat do të kenë ndikim të drejtpërdrejtë në përmirësimin e shëndetit të njeriut, kafshëve dhe bimëve.

**TË DREJTAT THEMELORE**

**Parimi dhe barazia**

Garancitë ligjore dhe dispozitat shoqërore do të sigurojnë të drejta të barabarta për të gjitha palët.

**Ndikimi në të drejtat themelore dhe administrimi i mirë**

Me përmirësimin e kësaj politike, procedurat administrative do të jenë më transparente, do të eliminohen procedurat e tepërta burokratike dhe të përcaktohen afatet procedurale për zgjidhjen e lëndëve.

**Të dhënat personale** – do të ketë ndikim / ndryshime në të drejtat e individëve dhe të dhënave personale.

**<u>Rekomandimi për opsionet</u>**

**Opsioni 1** Ky opsion nuk duhet të jete i zbatueshëm për shkak të pasojave potencialisht për regjistrimin, tregtimin dhe përdorimin e PMB-ve me kornizën aktuale ligjore. Zgjedhja e këtij opsioni do të nënkuptonte pranimin e mungesës së qasjes koherente dhe gjithëpërfshirëse në fushën e mbrojtjes se bimëve nga sëmundjet dhe dëmtuesit e bimëve.

Objektivat kryesore, - Me opsionin e parë nuk do të arriheshin rolet dhe përgjegjësitë e të gjithë akterëve të përfshirë në sektroin e MB-ve do të vazhdojnë të mos jenë të qarta dhe nuk do të ketë fokus të mjaftueshëm lidhur mbrojtjen e bimëve nga sëmundjet dhe dëmtuesit e si rezultat do të ketë ndikim negativ në shëndetin e njerëzve dhe kafshëve.

Ky opsion nuk ofron mundësi as për arritjen e objektivave sa i takon zvogëlimit të barrës administrative, pasi që ai nuk parasheh kurrfarë intervenimesh.

**Opsioni 2** do të kishte përmirësim dhe qartësi të lehtë të dispozitave për Shëndetin e Bimëve nga njëra anë, por pa adresuar opsionet e politikave dhe zhvillimet e përcaktuara në Kapitullin 1 të këtij dokumenti. Përfitimet që lidhen me këtë opsion janë vetëm se do të ketë më shumë sqarime të rregulluara me legjislacion. Duke bashkuar të gjithë legjislacionin ekzistues në një vend, do të kishte një thjeshtësi të përmirësuar për palët me interes që kërkojnë legjislacionin me të cilin do të kuptonin detyrimet e tyre. Nëse zgjidhet opsioni 2, do të humbet mundësia kyçe për të adresuar mangësitë e plota në legjislacionin aktual dhe problemet për shkak të mungesës së politikave të përgjithshme siç përshkruhet në këtë dokument në veçanti fokusi i pamjaftueshëm lidhur me MB-ve.

Intervenimet e kufizuara të parapara në këtë opsion sa i takon barrës administrative do të ofronin efekte sipërfaqësore sa i takon zvogëlimit të barrës ligjore. Pamundësia e ndryshimeve ligjore, nuk lejon thjeshtimin e procedurave, uljen e taksave dhe shkurtimin e kohës për shërbime. Për më tepër, korniza e tanishme ligjore nuk promovon komunikimin elektronik, gjë që vështirëson edhe më tej përpjekjet për digjitalizim, e që paraqet mjetin më të përshtatshëm për zvogëlim të barrës administrative.

**Opsioni 3** Nënkupton krijimin e kornizës rregullative, horizontale, transparente, gjithëpërfshirëse dhe të qartë të bazuar në qeverisjen e mirë dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare, të fokusuar në masat parandaluese afatgjate, siç parashikohet nga Rregullorja (BE) Nr. Nr.2016/2031. Ky opsion pritet të ketë ndikim më të qartë dhe direkt, sepse do të mundësoj ndryshime legjislative në politikën e Shëndetit të Bimëve dhe ofron fleksibilitet më të madh dhe barrë administrative më të ulët.

Ndikimet ekonomike priten të jenë pozitive. Së pari, janë përfitimet e pritshme për kërtollën dhe menaxhimin e dëmtuesve dhe përmirësimi i gjendjes shëndetësore të bimëve në vend, për sa i përket përfitimeve të drejtpërdrejta financiare nga reduktimi i paraqitjes së agjenteve të dëmshëm biologjik. Përmirësimi i gjendjes së shëndetit të bimëve do të kontribuojë gjithashtu në përmirësimin e prodhimeve bujqësore vendore nëpërmjet vlerës më të lartë të prodhimit dhe mundësive të reja të punësimit.

Megjithëse nuk mund të pritet rritje e lartë e punësimit, supozohet se shkalla e punësimit do të rritet lehtësisht me ndikim më të fortë në terma afatgjatë. Pritet që të kërkohet më shumë staf i kualifikuar, por edhe në këtë rast efektet do të shihen në planin afatgjatë. Rrjedhimisht, stafi i trajnuar profesionalisht dhe i avancuar mund të marrë paga më të larta.

Njohurit për dëmtuesit do të duhej të përqendroheshin në përmirësimin e informacioneve lidhur me rrezikun më të lartë për shëndetin e njerëzve, kafshëve dhe mjedisit nga paraqitjet e reja te dëmtuesve.

Për më tepër, detyrimet për operatorët janë shumë më të qarta dhe që në terma afatgjatë lehtësojnë procedurën e administrimit. Këto ndryshime në politikën e Shëndetit të Bimëve do të kenë efekt në përmirësimin e gjendjës në këtë sektor që kontribuonë në radhë të parë në vlerën më të lartë të prodhimit dhe konkurrencës, duke rritur kështu mundësitë e reja që kanë efekte në treg. Opsioni i propozuar do të lehtësoj procesin e mbajtjes së regjistrave fitosanitare për prodhim, paketim, përpunim, importim, eksportim, deponim, shpërndarje të bimëve, produkteve bimore dhe objekteve tjera.

Gjithashtu, tek bizneset do të ketë efekt pozitiv për investime vendore dhe të huaja për shkak të situatës më të mirë të sektorit të Shëndetit të Bimëve në vend. Në përgjithësi, rritje ekonomike pozitive pritet të përcaktohet nga produktiviteti më i lartë dhe potenciali i rritjes së prodhimeve bujqësore vendore. Kontributi i pritshëm në ekonomi pritet të jap efekt duke ulur importet dhe duke rritur kontributin në uljen e mundshme të inflacionit.

Ndikimi do të jetë pozitiv për sa i përket përfitimeve nga arritja e standardeve të qëndrueshme për SHB-ve. Kjo në terma afatgjatë mund të kontribuojë në përmirësimin e prodhimtarisë bujqësore dhe në zbutjen e varfërisë në zonat rurale nëpërmjet vlerës më të lartë të prodhimit dhe mundësive të reja të punësimit.

Edukimi i fermerëve për dëmtuesit e bimëve mund te jetë në favorin e tyre në rritje e prodhimit, biosigurisë, shëndetit të njeriut, praktikat e mira për përdorim të qëndrueshëm dhe mbrojtje të mjedisit.

Në anën tjetër, ky opsion parasheh ndryshime ligjore, na lejon të harmonizojmë dispozitat rreth ofrimit të shërbimeve me kërkesat e LPPA, gjë që do të shpie në rregullimin e tarifave por dhe në përmirësimin e shërbimeve sa i përket kohës. Për më tepër, ndryshimet ligjore na mundësojnë të zhvillojmë procedura, gjë që do të na lejojë t'i digjitalizojmë plotësisht shërbimet në fjalë në një të ardhme të afërt. Ky opsion ofron adresim të drejtë sa i takon barrës administrative.

Procesi i konsultimit synon:

- [Jepni informacionin këtu: Konsultimi paraprak me palët me interes, institucionet akademike, shoqërinë civile dhe organizatat qeveritare dhe jo qeveritare lidhur me nismat e MBPZHR për adresimin e çështjeve të veterinarisë dhe shëndetit publik në përgjithësi përmes legjislacionit dhe opinionet e tyre lidhur me këtë nismë]
- [Kur KD-ja dërgohet për konsultime publike, kolona për buxhet duhet të fshihet]
- [Kur KD-ja dërgohet për konsultime publike, titulli i kolonës 'Afati Indikativ' duhet të ndryshohet në 'Afati kohor']

| **Qëllimi kryesor** | **Grupi i synuar** | **Aktiviteti** | **Komunikimi/njoftimi** | **Afati indikativ** | **Buxheti i nevojshëm** | **Personi përgjegjës** |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Konsultimi për definimin e problemit | Të gjitha palët e interesuara | Takimi i parë publik | Njoftimi i dërguar përmes postës elektronike zyrtare | | Projekti i ZKM | Nehat Veliu |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Konsultimi paraprak ndërministror | Incitucionet relevante sipas nenit 7 të Rregullores së Punës së Qeverisë | Dërgimi i draft KD | Përmes postës elektronike zyrtare | | | Isah Rudaku Nehat Veliu |
| Konsultimi publik me shkrim | Incitucionet relevante, palët e interesuara | Publikimi i draft KD në portalin e konsultimeve publike | Publikimi në ueb faqe dhe në llogarinë e facebook-ut të MBPZhR-së dhe njoftimi për mediat vendore | | | Isah Rudaku Nehat Veliu |
| Konsultimi për draftin e parë të KD | Të gjitha palët e interesuara, mbrojtësit e bimëve, institucionet akademike, shoqatat e mbrojtjes se bimëve dhe bizneset qe tregtojnë me PMB-të, donatorët dhe zyrtarët e komunave | 7 Takime të fokusuara në pjesë të ndryshme të vendit si dhe një takim me donatorë. | Njoftimi i dërguar përmes postës elektronike zyrtare, përmes ueb faqeve të komunave, rrjetit social facebook të MBPZHR-së.<br><br>Njoftimi i mediave lokale për përcjelljen e aktivitetit<br><br>Për takimin me donatorë të njoftohen të gjitha mediat qendrore | | Projekti i ZKM | Nehat Veliu |

**Kapitulli 5: Komunikimi dhe konsultimi**
**Përmbledhje nga aktivitetet për hartimin e Koncept Dokumentit për Shëndetin e Bimeve**

Aktiviteti për hartimin e Koncept Dokumentit për Shëndetin e Bimëve ka filluar me formimin e ekipit punues për hartimin e Koncept Dokumentit për Mbrojtjen e Bimëve me datën 09.02.2024 i përberë prej 13 anëtaresh. Pastaj, me datën 23.02.2024 ekipi punues ka mbajtur takimin fillestar ku kemi diskutuar për rëndësinë dhe objektivat për Koncept Dokumenti i cili i paraprinë Hartimit të Ligjit për Shëndetin e Bimëve, mënyrat dhe hapat e mëtutjeshëm se si të punohet/procedohet aktiviteti për vazhdimin e punës deri në finalizim. Takimi publik me palët e interesuara është mbajtur me datën 26.04.2024, është përgatitur ftesa dhe në këtë takim janë ftuar palët me interes si: Përfaqësuesi nga MBPZHR, AUV, IBK, Dogana e Kosovës, FB&V, MMPHI, ZKM dhe përfaqësues i subjektit juridik Agropharma SH.P.K.

Ndërkaq, ftesës për pjesëmarrje i janë përgjigjur këto institucione: MBPZHR, DPBT, AUV, IBK – ja, MMPHI dhe ZKM –ja.

Grupi punues ka prezantuar para pjesëmarrësve fillimin e punës së Koncept Dokumentit dhe janë përcaktuar çështjet dhe temat kryesore që duhet të përfshihen në analizat për hartimin e këtij Koncept Dokumenti për Mbrojtjen e Bimëve i cili i paraprin hartimit të ligjit për Shëndetin e Bimëve në harmoni me Direktivën 2016/2031 mbi masat Mbrojtëse kundër dëmtuesve të bimëve.

Pastaj, në bazë të planit të punës është organizuar një punëtori tri ditore me datën 28-30. 05.2024 për vazhdimin e hartimit të Koncept Dokumentit të Shëndetit të Bimëve ku grupi punues ka bërë finalizimin e draftit fillestar të këtij Koncept Dokumenti.

Konsultime paraprake ndërministrore nga data: ////

Konsultimi publik nga data /////

Publikimi në platformën online nga data: ////,

Njoftimi për këtë në rrjetin social Facebook të MBPZHR-së, bashkë me këtë dhe hartimi i njoftimit (lajmit) për web faqen e MBPZHR-së dhe media.

Të gjitha publikimet në media që lidhen me temën e koncept dokumentit do të bashkëngjiten përmes linçeve në këtë koncept.

## Kapitulli 6 Krahasimi i opsioneve dhe ndikimeve të tyre

Opsioni 1 Mos ndryshimi i gjendjës aktuale sipas këtij opsioni do të vazhdoj që objektivat për shëndetin e bimëve të mos arrihen. Për më shumë, përgjegjësitë e akterëve të përfshirë në sektorin e shëndetit të bimëve do të vazhdojnë të mos jenë të qarta lidhur me fushën e shëndetit të bimëve për sëmundjet dhe dëmtuesit në përputhje me legjislacionin e BE-së për shëndetin e bimëve. Opsioni nuk parasheh intervenime për zvogëlim të barrës administrative.

Opsioni 2 do të kishte përmirësim dhe qartësi të lehtë të dispozitave për Shëndetin e Bimëve nga njëra anë, por pa adresuar opsionet e politikave dhe zhvillimet e përcaktuara në Kapitullin 1 të këtij dokumenti. Përfitimet që lidhen me këtë opsion janë vetëm se do të ketë më shumë sqarime të rregulluara me legjislacion. Duke bashkuar të gjithë legjislacionin ekzistues në një vend, do të kishte një thjeshtësi të përmirësuar për palët me interes që kërkojnë legjislacionin me të cilin do të kuptonin detyrimet e tyre. Nëse zgjidhet opsioni 2, do të humben mundësitë kyçe për të adresuar mangësitë e plota në legjislacionin aktual dhe problemet për shkak të mungesës së politikave të përgjithshme. Gjithashtu, ky opsion ofron një numër të kufizuar të masave për zvogëlim të barrës administrative. Për këtë arsye, ndikimet në zvogëlim të barrës mbesin jo-optimale.

